



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E PROSPEKTIT QË PUBLIKOHET KUR TITUJT I
OFROHEN PUBLIKUT DHE/OSE PRANOHEN PËR TREGTIM NË NJË TREG TË
RREGULLUAR

Miraturar me Vendim Bordi nr. 4, datë 26.01.2023

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i rregullores

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë:
 - a) formën dhe përmbajtjen e prospektit të plotë, elementët kryesorë të tij, si dhe miratimin dhe regjistrimin e prospektit për ofertën e titujve drejtuar publikut dhe/ose pranimin e titujve për tregtim në një treg të rregulluar, të regjistruar apo të njohur në Republikën e Shqipërisë;
 - b) formën dhe përmbajtjen e suplementit që i shtohet prospektit;
 - c) formën dhe përmbajtjen e dokumentit të regjistrimit, shënimit mbi titullin dhe përmbledhjen e prospektit, kur prospekti përbëhet nga këto dokumenta;
 - d) procedurën për miratimin e prospektit.
2. Kjo rregullore përcakton, gjithashtu, kërkesa kur emetuesi me seli jashtë Republikës së Shqipërisë mund të ofrojë tituj në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 248 pika 1 dhe nenit 249 pika 4 dhe 5 të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020, “Për Tregjet e Kapitalit”, këtu e më poshtë, përmendur si ‘Ligji’.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga emetuesi me seli brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë për ofertën e titujve drejtuar publikut dhe/ose pranimin e titujve për tregtim në një treg të rregulluar në përputhje me nenin 243 dhe nenin 284 të Ligjit.

Neni 4

Përjashtime

Kjo rregullore nuk zbatohet për:

- a) ofertat e titujve për të cilat zbatohet përjashtimi për publikimin e një prospekti, në përputhje me nenin 244 të Ligjit,
- b) titujt që përjashtohen sipas nenit 245 të Ligjit.

Neni 5

Përkufizime

1. Në këtë rregullore, termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:

‘ndërmjetës financiar’ është shoqëria komisionere apo banka e licencuar/e regjistruar/e njohur në Republikën e Shqipërisë për të ofruar shërbimin e nënshkrimit të titujve dhe/ose hedhjes në treg të titujve në bazë të angazhimit në transaksion apo hedhjes në treg të titujve pa angazhim shitjeje, në përputhje me nenin 2, pika 48, shkronja (f) dhe (g) e Ligjit.

2. Të gjitha përkufizimet e tjera kanë të njëjtin kuptim me ato që parashikon Ligji.

Neni 6

Detyrimi për publikimin e Prospektit

1. Titujt në Republikën e Shqipërisë i ofrohen publikut vetëm pas publikimit të një Prospekti, në përputhje me Ligjin dhe këtë rregullore.
2. Titujt pranohen për tregtim në një treg të rregulluar të licencuar, të regjistruar ose të njohur brenda Republikës së Shqipërisë, vetëm pas publikimit të një Prospekti, në përputhje me Ligjin dhe këtë rregullore.

Neni 7

Prospekti vullnetar

1. Pavarësisht përjashtimit nga detyrimi për të publikuar një prospekt, në përputhje me nenin 244 dhe 245 të Ligjit, titujt mund të ofrohen dhe/ose të pranohen për tregtim në një treg të rregulluar nëpërmjet hartimit vullnetarisht të prospektit nga emetuesi, në përputhje me Ligjin dhe këtë rregullore.

2. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni bëjnë titujt sipas shkronjave “a”, “d”, “dh” dhe “e” të nenit 245 të Ligjit.
3. Prospekti i hartuar vullnetarisht miratohet nga Autoriteti dhe përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga Ligji dhe kjo rregullore për prospektin.

KREU II HARTIMI I PROSPEKTIT

Neni 8 Forma dhe përmbajtja e prospektit

1. Prospekti mund të paraqitet si një dokument i vetëm ose mund të përbëhet nga disa dokumente të veçanta.
2. Prospekti duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për të mundësuar vlerësimin e:
 - a) aktiveve dhe pasiveve, humbjeve dhe fitimeve, gjendjes financiare dhe perspektivave të emetuesit dhe të garantit, nëse ka,
 - b) të drejtave që lidhen me titujt, dhe
 - c) qëllimit/ve për emetimin e titujve/destinacionin e përdorimit të fondeve, si dhe
 - d) ndikimit tek emetuesi.
3. Në rastin kur prospekti paraqitet si një dokument i vetëm, forma dhe përmbajtja do të jetë sipas Shtojcës I të kësaj rregulloreje.
4. Në rastin kur prospekti përbëhet nga disa dokumente të veçanta, këto dokumente janë: dokumenti i regjistrimit, shënimi mbi titullin dhe përmbledhja. Forma dhe përmbajtja e dokumentit të regjistrimit do të jetë sipas Shtojcës II, forma dhe përmbajtja e shënimit mbi titullin do të jetë sipas Shtojcës III dhe forma dhe përmbajtja e përmbledhjes sipas Shtojcës IV të kësaj rregulloreje.
5. Informacioni i paraqitur në prospektin si dokument i vetëm apo i përbërë nga disa dokumente të veçanta hartohet dhe prezantohet në formë lehtësisht të analizueshme, koncize dhe të kuptueshme duke marrë parasysh faktorët dhe informacionin e parashikuar në pikën (2) të këtij neni.
6. Për prospektin e paraqitur si dokument i vetëm gjen zbatim Kreu III i kësaj rregulloreje. Për prospektin e përbërë nga disa dokumente të veçanta gjen zbatim Kreu IV i kësaj rregulloreje.

Neni 9 Dokumentet që shoqërojnë prospektin

1. Prospekti i paraqitur si dokument i vetëm, në përputhje me nenin 8 pika 3 të kësaj rregulloreje apo që përbëhet prej disa dokumenteve të veçanta, në përputhje me nenin 8 pika 4 të kësaj rregulloreje, dorëzohet së bashku me dokumentet e mëposhtme:

- a. dëshmi penaliteti, që vërteton gjendjen penale të administratorit, anëtarëve të këshillit mbikëqyrës/administrimit dhe aksionarit/ve influencues;
 - b. vendimi i organit kompetent të emetuesit për ofertën e titujve drejtuar publikut, apo pranimin për tregtim;
 - c. letër konfirmimi/miratimi nga autoriteti kompetent rregullator i vendit të origjinës së emetuesit (sipas rastit);
 - d. kontrata me audituesin ligjor të emetuesit për vitin financiar ushtrimor pasardhës;
 - e. dokument që vërteton kryerjen e pagesës ndaj Autoritetit.
2. Përfshihet nga zbatimi i kërkesës së pikës 1/a të këtij neni, rasti kur emetuesi i titujve është një subjekt financiar i mbikëqyrur.

Neni 10 **Informacione të rëndësishme**

1. Prospekti i hartuar si dokument i vetëm apo i përbërë prej dokumenteve të veçanta përmban një deklaratë lehtësisht të dallueshme, që përfshin informacionet e rëndësishme në vijim:
 - a) deklaratën e emetuesit se Autoriteti ka verifikuar vetëm që prospekti përmban të gjithë informacionin e kërkuar, sipas kërkesave të Ligjit dhe se Autoriteti nuk verifikon saktësinë apo vërtetësinë e informacioneve të paraqitura në prospekt, si dhe nuk mban përgjegjësi për saktësinë apo vërtetësinë e informacioneve të paraqitura në të,
 - b) deklaratën e administratorit/ve të emetuesit se i gjithë informacioni që përmban prospekti, në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje është i saktë e korrekt dhe se nuk është hequr asnjë informacion që ndikon në saktësinë dhe tërësinë e informacionit,
 - c) deklaratën e emetuesit se çdo investitor ka përgjegjësi ekskluzive për vendimin e tij për të investuar në tituj, mbështetur në informacionin e ofruar në prospekt dhe nëse është i pasigurt për investimin është mirë të konsultohet me një profesionist të fushës.
2. Deklarata e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përfshihet në hyrjen e prospektit. Nëse dorëzohet si dokument i vetëm, deklarata do të jetë sipas Shtojcës I të kësaj rregulloreje dhe, nëse përbëhet nga disa dokumente të veçanta, deklarata do të jetë sipas dokumentit “Përmbledhja e Prospektit“ në Shtojcën IV të kësaj rregulloreje.

Neni 11 **Faktorët e rrezikut**

1. Faktorët e rrezikut, që përfshihen në prospekt, kufizohen minimalisht te rreziqet specifike të emetuesit dhe të titujve.
2. Gjatë hartimit të prospektit, emetuesi vlerëson faktorët e rrezikut, mbështetur në probabilitetin e shfaqjes së tyre dhe shkallën e pritshme të ndikimit të tyre negativ tek emetuesi.

3. Secili faktor rreziku përshkruhet mjaftueshëm, duke shpjeguar sesi ndikon tek emetuesi ose te titujt që ofrohen apo pranohen për t'u tregtuar. Vlerësimi i faktorëve të rrezikut, mbështetur në probabilitetin e ndodhjes dhe shkallën e pritshme të ndikimit të tyre negativ mund të kryhet ose duke përdorur një renditje cilësore, si i ulët, mesatar, i lartë, ose duke i renditur faktorët e rrezikut sipas probabilitetit të shfaqjes së tyre.
4. Faktorët e rrezikut paraqiten në një numër të kufizuar kategorish, në varësi të natyrës së tyre.

Neni 12

Çmimi përfundimtar i ofertës dhe sasia e titujve

1. Në rast se çmimi përfundimtar i ofertës dhe/ose sasia e titujve që do t'i ofrohet publikut dhe/ose do të pranohet për tregtim në një treg të rregulluar, qofshin të shprehura në numër titujsh apo si vlerë e përgjithshme nominale, nuk mund të përfshihen në prospekt në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë Autoritetit:
 - a) investitori mund të tërhiqet nga pranimi për blerjen apo nënshkrimin e titujve për jo më pak se dy ditë pune pas publikimit të çmimit final të ofertës;
 - b) në prospekt duhet të jepet informacioni vijues:
 - i) çmimi maksimal i pritshëm dhe/ose vlera maksimale e pritshme e titujve, për aq sa ato janë të disponueshme; ose
 - ii) metodat dhe kriteret e vlerësimit dhe/ose kushtet, sipas të cilave do të përcaktohet çmimi përfundimtar i ofertës, si dhe një shpjegim i çdo metode të vlerësimit që është përdorur.
2. Çmimi përfundimtar i ofertës dhe/ose sasia e titujve i paraqiten më pas Autoritetit dhe i vihen në dispozicion publikut në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 26 pika 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Heqja e informacionit

1. Autoriteti mund të lejojë heqjen e informacioneve të caktuara nga prospekti ose nga pjesët e tij përbërëse, kur vlerëson se përmbushet një nga kushtet në vijim:
 - a) dhënia e këtij informacioni do të ishte në kundërshtim me interesin publik;
 - b) dhënia e këtij informacioni do të dëmtonte seriozisht emetuesin ose garantin, nëse ka, me kusht që heqja e këtij informacioni të mos keqinformojë publikun lidhur me faktet dhe rrethanat thelbësore për një vlerësim të informuar të emetuesit dhe garantit, nëse ka, dhe të të drejtave që lidhen me titujt të cilëve u referohet prospekti;
 - c) ky informacion ka pak rëndësi në lidhje me një ofertë specifike ose pranimin për tregtim në një treg të rregulluar dhe nuk do të ndikonte vlerësimin e pozicionit financiar dhe perspektivat e emetuesit ose garantit, nëse ka.

2. Me kusht që investitorëve t'u jepet informacioni i mjaftueshëm, kur, përjashtimisht, informacione të caktuara që kërkohet të përfshihen në prospekt ose në një prej pjesëve të tij përbërëse janë të papërshtatshme për fushën e veprimtarisë ose për formën juridike të emetuesit ose garantit, nëse ka, ose për titujt me të cilët ka të bëjë prospekti, prospekti ose pjesët e tij përbërëse do të përmbajnë informacione të barasvlershme me informacionin e kërkuar, përveçse kur ky informacion nuk ekziston.

KREU III

RREGULLA KUR PROSPEKTI PARAQITET SI DOKUMENT I VETËM

Neni 14

Kërkesa

Emetuesi i paraqet Autoritetit kërkesën për miratim të prospektit për ofrimin e titujve publikut apo pranimin e titujve për tregtim në treg të rregulluar, duke e shoqëruar me informacionin dhe dokumentet e përcaktuara në nenin 8 pika 2 dhe 3 dhe nenin 9 të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Përgjegjësia që lidhet me prospektin

Autoriteti sigurohet që përgjegjësia për informacionin e paraqitur në prospekt dhe çdo suplement të tij, i ngarkohet emetuesit dhe organeve të tij administrative ose mbikëqyrëse. Personat përgjegjës për prospektin dhe suplementin e tij duhet të identifikohen qartë në prospekt me emër dhe adresë të regjistruar, si dhe me anë të një deklaratë prej tyre që, për aq sa ata kanë dijeni, informacioni që përmban prospekti është në përputhje me faktet dhe se nga ai nuk është hequr asgjë që mund të ndikojë në kuptimin e tij.

Neni 16

Vlefshmëria e prospektit

Prospekti i paraqitur si dokument i vetëm është i vlefshëm për 12 [dymbëdhjetë] muaj nga miratimi i prospektit për ofertën publike dhe/ose pranimin për tregtim në një treg të rregulluar, me kusht që të plotësohet me çdo suplement të kërkuar sipas nenit 28 të kësaj rregulloreje.

KREU IV

RREGULLA KUR PROSPEKTI PËRBËHET NGA DISA DOKUMENTE TË VEÇANTA

Neni 17

Kërkesa

Emetuesi i paraqet Autoritetit kërkesën për miratim të prospektit për ofrimin e titujve publikut dhe/ose pranimin e titujve për tregtim në treg të rregulluar, duke e shoqëruar informacionin dhe dokumentet në përputhje me nenin 8 pika 2 dhe 4, si dhe nenin 9 të kësaj rregulloreje.

Neni 18

Përgjegjësia që lidhet me prospektin

Autoriteti sigurohet që përgjegjësia për informacionin e paraqitur në prospekt dhe çdo suplement të tij, i ngarkohet emetuesit dhe organeve të tij administrative, apo mbikëqyrëse. Personat përgjegjës për prospektin dhe suplementin e tij identifikohen qartë në prospekt me emër dhe adresë të regjistruar, si dhe me anë të një deklarate prej tyre që, për aq sa ata kanë dijeni, informacioni që përmban prospekti është në përputhje me faktet dhe se nga ai nuk është hequr asgjë që mund të ndikojë në kuptimin e tij.

Neni 19

Vlefshmëria e prospektit

1. Kur prospekti përbëhet nga disa dokumente të veçanta, vlefshmëria e tij fillon nga data e miratimit të shënimit mbi titullin.
2. Dokumenti i regjistrimit, i cili është miratuar më parë do të jetë i vlefshëm si pjesë e prospektit për 12 muaj nga miratimi i tij.
3. Përfundimi i vlefshmërisë së dokumentit të regjistrimit sipas pikës 2 të këtij neni nuk ndikon në vlefshmërinë e prospektit.

Neni 20

Përmbledhja e prospektit

1. Prospekti i përbërë nga disa dokumente të veçanta përfshin përmbledhjen e parashikuar në nenin 249 (1), shkronja (c) e Ligjit, që përcakton informacionin kryesor që u nevojitet investitorëve për të kuptuar natyrën dhe rreziqet e emetuesit dhe të garantit, nëse ka, si dhe të titujve të ofruar dhe të pranuar për t'u tregtuar në një treg të rregulluar. Ky dokument duhet lexuar së bashku me dokumentin e regjistrimit, sipas nenit 249 (1), shkronja (a) dhe shënimit mbi titullin, sipas nenit 249 (1), shkronja (b) e Ligjit për të ndihmuar investitorët, kur marrin në konsideratë të investojnë në këta tituj.
2. Përmbajtja e përmbledhjes duhet të jetë e saktë, e drejtë dhe e qartë dhe nuk duhet të jetë çorientuese. Ajo duhet lexuar si hyrje e prospektit dhe është në një linjë me pjesët e tjera të prospektit.
3. Përmbledhja hartohet si një dokument i shkurtër, i shkruar në mënyrë koncize dhe jo më shumë se 7 [shtatë] faqe, e printuar në format A4. Përmbledhja paraqitet dhe formatohet në mënyrë të tillë që të jetë e lehtë për t'u lexuar, duke përdorur karaktere me madhësi të lexueshme. Përmbledhja shkruhet në një gjuhë dhe stil që e bëjnë informacionin të lehtë për t'u kuptuar, veçanërisht, në një gjuhë të qartë, joteknike, koncize dhe të kuptueshme për investitorët.

Neni 21

Dokumenti universal i regjistrimit

1. Emetuesi, titujt e të cilit i janë ofruar tashmë publikut dhe janë pranuar për t'u tregtuar në një treg të rregulluar mund të hartojë çdo vit financiar një dokument regjistrimi në formën e dokumentit universal të regjistrimit.
2. Dokumenti universal i regjistrimit përshkruan organizimin e shoqërisë tregtare, biznesin, pozicionin financiar, fitimet dhe perspektivat, qeverisjen dhe strukturën aksionare. Dokumenti i regjistrimit miratohet nga Autoriteti, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 25, pika 4 dhe 6 të kësaj rregulloreje.
3. Emetuesi, i cili zgjedh të hartojë dokumentin universal të regjistrimit çdo vit financiar, e depoziton për miratim pranë Autoritetit.
4. Autoriteti, në gjykim të tij, mund të miratojë dokumentin universal të regjistrimit, për dy vite financiare të njëpasnjëshme.
5. Pas miratimit të dokumentit të regjistrimit nga Autoriteti për dy vite të njëpasnjëshme financiare, në bazë të pikës 4 të këtij neni, dokumentet vijuese të regjistrimit mund të depozitohen pranë Autoritetit pa miratim paraprak.
6. Në rast se emetuesi nuk depoziton dokumentin universal të regjistrimit për një vit financiar, humbet të drejtën e depozitimit të dokumentit pa miratim paraprak dhe të gjitha dokumente vijuese të regjistrimit i paraqiten për miratim Autoritetit, derisa të plotësohen sërish kushtet e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni.
7. Emetuesi shënon në kërkesën e tij drejtuar Autoritetit nëse dokumenti universal i regjistrimit është dorëzuar për miratim apo për depozitim pa miratim paraprak, kur dokumenti i regjistrimit është miratuar nga Autoriteti për dy vite të njëpasnjëshme financiare, sipas pikës 4 të këtij neni.
8. Pas miratimit ose depozitimit pa miratim paraprak, dokumenti universal i regjistrimit, si dhe ndryshimi i tij i përmendur në pikat 9 dhe 11 të këtij neni i vihen pa vonesë në dispozicion publikut, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 26 të kësaj rregulloreje.
9. Pas dorëzimit ose miratimit të dokumentit universal të regjistrimit, emetuesi mund të përditësojë në çdo kohë informacionet që përmban ai duke ia paraqitur ndryshimin Autoritetit.
10. Autoriteti mund të rishikojë në çdo kohë përmbajtjen e çdo dokumenti universal regjistrimi që është dorëzuar pa miratim paraprak, si dhe përmbajtjen e të gjitha ndryshimeve të tyre. Rishikimi nga Autoriteti përfshin verifikimin nëse informacioni i paraqitur në dokumentin universal të regjistrimit dhe ndryshimet e tij janë të plota, të njëtrajtshme dhe të kuptueshme.
11. Kur, gjatë shqyrtimit, Autoriteti konstaton se dokumenti universal i regjistrimit nuk plotëson standardet për të qenë i plotë, i njëtrajtshëm dhe i kuptueshëm ose ka nevojë për ndryshime apo informacion shtesë, informon emetuesin. Emetuesi duhet të marrë në

konsideratë kërkesën e Autoritetit për ndryshime ose informacione shtesë. Autoriteti njofton emetuesin se kërkesa e tij për ndryshim ose informacion shtesë lidhet me një ngjarje materiale, gabim material ose pasaktësi, që ka gjasë të çorientojë publikun në raport me fakte dhe rrethana thelbësore për një vlerësim të informuar të emetuesit. Emetuesi, në të dyja rrethanat, dorëzon pa vonesë ndryshimin e dokumentit universal të regjistrimit.

Neni 22 **Shënimi mbi titullin**

Prospekti i përbërë nga disa dokumente të veçanta përfshin edhe dokumentin ‘shënim mbi titullin’, në bazë të nenit 249, pika 1, shkronja (b) e Ligjit.

Neni 23 **Prospekti i përbërë nga disa dokumente të veçanta**

1. Emetuesi, që ka marrë miratimin nga Autoriteti për dokumentin e regjistrimit, kërkohet të hartojë vetëm dokumentin ‘shënim mbi titullin’ dhe përmbledhjen, kur titujt do i ofrohen publikut dhe/ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar.
2. Në rastin kur, që prej miratimit të dokumentit të regjistrimit ka ndodhur një ngjarje materiale, gabim material ose pasaktësi materiale që lidhet me informacionin e përfshirë në këtë dokument, që mund të ndikojë në vlerësimin e titujve, sipas nenit 28 të kësaj rregulloreje, emetuesi paraqitet për miratim një suplement, në të njëjtën kohë me dokumentin ‘shënim mbi titullin’ dhe përmbledhjen.
3. Përmbledhja, dokumenti i regjistrimit, shënimi mbi titullin dhe suplementi i tij, kur ka një të tillë, përbëjnë prospektin, pas miratimit nga Autoriteti.
4. Emetuesi që ka dokumentin universal të regjistrimit të miratuar nga Autoriteti, ose ka depozituar dokumentin universal të regjistrimit pa miratim paraprak, në bazë të nenit 21 pika 5 të kësaj rregulloreje, kërkohet të hartojë vetëm shënimin mbi titullin dhe përmbledhjen që miratohet nga Autoriteti.
5. Kur dokumenti universal i regjistrimit është miratuar sipas nenit 21 pika 4 të kësaj rregulloreje, shënimi mbi titullin, përmbledhja dhe të gjitha suplementet e dorëzuara që nga miratimi i dokumentit të regjistrimit i nënshtrohen një miratimi të veçantë.
6. Dokumenti universal i regjistrimit i depozituar në Autoritet pa miratim paraprak, kur bëhet pjesë e prospektit kërkon miratim të veçantë nga Autoriteti.

KREU V
RREGULLA PËR PARAQITJEN E KËRKESËS, MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN E
PROSPEKTIT

Neni 24
Paraqitja e kërkesës për prospektin

Emetuesi paraqet kërkesën për miratimin e prospektit për ofertën e titujve drejtuar publikut dhe/ose për pranimin për tregtim në një treg të rregulluar, mbështetur në nenin 8 pika 2 deri në 4 të kësaj rregulloreje dhe dokumentacionin sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje.

Neni 25
Shqyrtimi dhe miratimi i prospektit

1. Prospekti i paraqitur si dokument i vetëm, në përputhje me nenin 8 pika 3 të kësaj rregulloreje nuk publikohet pa miratimin e Autoritetit.
2. Prospekti i përbërë prej disa dokumenteve të veçanta, në përputhje me nenin 8 pika 4 të kësaj rregulloreje, nuk publikohet pa miratimin nga Autoriteti të të gjitha dokumenteve.
3. Autoriteti merr vendim për miratimin e prospektit të paraqitur si dokument i vetëm brenda 30 ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë.
4. Autoriteti merr vendim për miratimin e prospektit të përbërë nga disa dokumente të veçanta brenda 25 ditëve pune nga dorëzimi i përmbledhjes, dokumentit të regjistrimit dhe shënimit mbi titullin.
5. Kur Autoriteti nuk merr vendim lidhur me prospektin brenda afateve të përcaktuara në pikat 3 deri në 4 të këtij neni, mosmarrja e vendimit nuk konsiderohet se përbën miratim të kërkesës.
6. Kur Autoriteti konstaton se prospekti nuk i përmbush standardet si i plotë, i kuptueshëm dhe i njëtrajtshëm, të nevojshme për miratimin e tij dhe/ose nëse konstatohen mangësi ose parregullsi dhe/ose kur është nevoja për ndryshime ose informacion shtesë:
 - a) njofton emetuesin mbi faktin e konstatuar me shkrim ose elektronikisht, dhe
 - b) përcakton qartë ndryshimet ose informacionin shtesë të nevojshëm.

Në këto raste, afati i parashikuar në pikën 3 dhe 4 të këtij neni zbatohet nga data e dorëzimit tek Autoriteti i prospektit të rishikuar ose i informacionit shtesë të kërkuar.

7. Autoriteti i kërkon emetuesit, në përputhje me pikën 6 të këtij neni, të dorëzojë prospektin e ndryshuar brenda 20 ditëve pune. Kur është e nevojshme, Autoriteti mund ta shtyjë këtë afat, sipas vlerësimit të tij.
8. Kur emetuesi nuk është në gjendje apo i gatshëm të bëjë ndryshimet e nevojshme apo të sigurojë informacionin shtesë të kërkuar në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni, Autoriteti ka të drejtë të refuzojë miratimin e prospektit dhe të ndërpresë procesin e

shqyrtimit. Në këtë rast, Autoriteti njofton emetuesin për vendimin e tij dhe paraqet arsyet e këtij refuzimi.

Neni 26

Publikimi i prospektit

1. Pas miratimit, prospekti i vihet në dispozicion publikut nga emetuesi brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se data e parë e fillimit të ofertës për publikun dhe/ose pranimit për tregtim të titujve, e përfshirë në prospekt.
2. Informacioni dhe të dhënat që përfshijnë Numrin kombëtar ose ndërkombëtar të identifikimit të titullit, data e miratimit dhe çmimi përfundimtar i ofertës, që nuk mund të bëheshin pjesë e prospektit gjatë kohës së kërkesës dhe miratimit nga Autoriteti, do t'i paraqiten më pas Autoritetit dhe do të vihen në dispozicion të publikut në përputhje me pikën 3 të këtij neni.
3. Prospekti, ose kur paraqitet si dokument i vetëm, ose i përbërë nga disa dokumente të veçanta, konsiderohet se i është vënë në dispozicion publikut pas botimit në formë elektronike në cilëndo prej faqeve të mëposhtme të internetit:
 - a) faqja e internetit e emetuesit,
 - b) faqja e internetit e ndërmjetësve financiarë, të cilët nënshkruajnë, hedhin në treg ose shesin titujt,
 - c) faqja e internetit e tregut të rregulluar, ku kërkohet pranimi për tregtim.
4. Prospekti publikohet në një rubrikë të dedikuar të faqes së internetit, e cila konsultohet lehtësisht. Ai është në format elektronik që mundëson shkarkimin, shtypjen dhe kërkimin, por nuk mund t'i bëhen ndryshime.
5. Konsultimi i prospektit nuk kërkon kryerjen e procesit të regjistrimit, pranimin e ndonjë shënimi (disclaimer) që kufizon përgjegjësinë ligjore, apo pagesën e një tarife. Paralajmërimet që përmendin juridiksionin/juridikSIONET ku bëhet oferta apo pranimi për tregtim nuk do të jenë shënime (disclaimer) që kufizojnë përgjegjësinë ligjore.
6. Autoriteti publikon në faqen e tij të internetit prospektet e miratuara ose, të paktën, një listë të prospekteve të miratuara, përfshi një adresë interneti (hyperlink) në rubrikat e dedikuara të faqes së internetit, përmendur në pikën 3 të këtij neni. Lista e botuar, përfshirë hyperlink, mbahet e përditësuar dhe secili prej elementëve të listës qëndron në faqen e internetit të paktën për periudhën e parashikuar në pikën 8 të këtij neni.
7. Autoriteti publikon suplementet e prospektit sipas parashikimit të pikës 6 të këtij neni.
8. Të gjitha prospektet dhe shtesat e miratuara qëndrojnë në dispozicion të publikut në formë elektronike për të paktën 5 [pesë] vjet pas publikimit në faqet e internetit të përmendura në pikat 2 dhe 6 të këtij neni.
9. Prospekti i miratuar përmban një lajmërim të dukshëm që përcakton afatin e përfundimit të vlefshmërisë. Në lajmërim shkruhet po ashtu se detyrimi për plotësimin e prospektit në rastin e një ngjarjeje materiale, gabimi material apo pasaktësie nuk gjen zbatim, kur prospekti nuk është më i vlefshëm.

10. Në rastin e një prospekti që përbëhet nga disa dokumente të veçanta, përmbledhja, dokumenti i regjistrimit dhe shënimi mbi titullin që përbëjnë prospektin, mund të publikohen dhe të shpërndahen më vete, me kusht që këto dokumente t'i vihen në dispozicion publikut në përputhje me pikën 3 të këtij neni. Kur prospekti përbëhet nga disa dokumente, në përputhje me nenin 23 të kësaj rregulloreje dhe në përputhje me nenin 249 pika 3 të ligjit, në secilin prej dokumenteve përbërëse shënohet qartë se ky dokument është vetëm një prej pjesëve përbërëse të prospektit dhe se ku mund të sigurohen dokumentet e tjera përbërëse të prospektit.
11. Teksti dhe formati i prospektit dhe i çdo suplementi të prospektit që i janë vënë në dispozicion publikut janë gjithnjë të njëjta me variantin origjinal të miratuar nga Autoriteti.
12. Emetuesi ose ndërmjetësit financiarë që nënshkruajnë, hedhin në treg apo shesin titujt u dërgojnë investitorëve të mundshëm kopje të prospektit me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, sipas kërkesës dhe pa pagesë. Në rast se investitori i mundshëm bën kërkesë të posaçme për kopje në letër, Emetuesi ose ndërmjetësit financiarë që nënshkruajnë, hedhin në treg apo shesin titujt i dërgon/jnë variantin e shtypur të prospektit.

Neni 27 **Reklamat**

1. Çdo reklamë që ka të bëjë me ofrimin e titujve publikut apo pranimin për tregtim në një treg të rregulluar respekton parimet e përcaktuara në këtë nen.
2. Reklamat njoftojnë mbi publikimin e prospektit dhe u tregojnë investitorëve ku mund ta sigurojnë këtë prospekt.
3. Reklamat duhet të jenë qartësisht të dallueshme si të tilla. Reklama nuk duhet të përmbajë informacion të pasaktë apo çorientues dhe duhet të jetë në përputhje me informacionin që përmban prospekti i miratuar nga Autoriteti.
4. Të gjitha informacionet e dhëna me shkrim ose me gojë lidhur me ofrimin publikut dhe/ose pranimin e titujve për tregtim në një treg të rregulluar, edhe kur nuk kanë qëllim reklamimi, duhet të jenë në përputhje me informacionin që përmban prospekti i miratuar nga Autoriteti.
5. Autoriteti monitoron përputhshmërinë e aktivitetit reklamues për ofrimin e titujve publikut dhe/ose pranimin e tyre për tregtim në një treg të rregulluar me Ligjin dhe këtë rregullore.
6. Pa paragjykuar nenin 25 të kësaj rregulloreje, monitorimi i reklamave nga Autoriteti nuk përbën parakusht për ofrimin e titujve publikut dhe/ose pranimin për tregtim në një treg të rregulluar.

KREU VI SUPLEMENTI I PROSPEKTIT

Neni 28 Suplementi i prospektit

1. Çdo ngjarje e rëndësishme, gabim ose pasaktësi materiale lidhur me informacionin që përmban prospekti, i cili mund të ndikojë në vlerësimin e titujve dhe që ndodh midis kohës së miratimit të prospektit dhe datës së përfundimit të periudhës së ofrimit, si dhe midis datës së përfundimit të periudhës së ofrimit dhe kohës kur titujt pranohen për t'u tregtuar në treg të rregulluar, emetuesi paraqet një suplement që i bashkëlidhet pa vonesë prospektit, në përputhje e nenin 249, pika 4 të Ligjit.
2. Forma dhe përmbajtja e suplementit duhet të jetë sipas Shtojcës V të kësaj rregulloreje, pavarësisht nëse prospekti është paraqitur si dokument i vetëm apo i përbërë nga disa dokumente të veçanta.
3. Suplementi miratohet në të njëjtën mënyrë si prospekti brenda një afati maksimal prej 15 [pesëmbëdhjetë] ditë pune dhe publikohet në përputhje me të paktën të njëjtat rregulla të zbatuara për publikimin e prospektit fillestar, në përputhje me nenin 26 të kësaj rregulloreje.
4. Kur prospekti lidhet me ofertën e titujve për publikun, investitorët të cilët kanë rënë dakord të blejnë ose të nënshkruajnë titujt, përpara se të publikohet suplementi, kanë të drejtë të tërheqin pranimet e tyre, brenda 2 [dy] ditëve pune pas publikimit të suplementit, me kusht që ngjarjet e rëndësishme, gabimet materiale apo pasaktësitë e përmendura në pikën 1 të këtij neni të jenë shfaqur ose vërejtur përpara mbylljes së periudhës së ofertës ose dorëzimit të titujve, cilado ndodh e para. Ky afat mund të shtyhet nga emetuesi. Data përfundimtare e së drejtës për t'u tërhequr shënohet në suplement. Suplementi përmban një shënim të dukshëm lidhur me të drejtën për t'u tërhequr, ku shkruhet qartë se:
 - a) e drejta e tërheqjes u jepet vetëm atyre investitorëve që kanë rënë tashmë dakord të blejnë ose të nënshkruajnë titujt, përpara publikimit të suplementit dhe kur titujt nuk u ishin dhënë ende investitorëve në kohën kur ndodhën ose u vërejtën ngjarje të rëndësishme, gabime materiale ose pasaktësi;
 - b) periudha në të cilën investitorët mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të tërheqjes dhe
 - c) cilët duhet të kontaktojnë investitorët, nëse dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e tërheqjes.
5. Kur titujt blihen ose nënshkruhen përmes një ndërmjetësi financiar, ndërmjetësi financiar informon investitorët rreth mundësisë së publikimit të suplementit, ku dhe kur do të publikohet. Ndërmjetësi financiar i ndihmon investitorët për të ushtruar të drejtën e tërheqjes. Ndërmjetësi financiar kontakton investitorët ditën kur publikohet suplementi. Kur titujt blihen ose nënshkruhen drejtpërdrejt nga emetuesi, informimi i investitorëve për mundësinë e publikimit të suplementit dhe vendin e publikimit dhe se, në këtë rast, investitorët kanë të drejtën të tërhiqen, bëhet nga emetuesi.
6. Kur emetuesi përgatit një suplement të informacionit në prospekt, që lidhet vetëm me një ose disa çështje individuale, e drejta e investitorëve për të tërhequr pranimin e tyre, në

përputhje me pikën 4 të këtij neni, zbatohet vetëm për çështjen/çështjet përkatëse dhe jo për çështje të tjera të titujve në prospekt.

7. Kur shqyrton suplementin përpara miratimit, Autoriteti mund të kërkojë që suplementi të përmbajë një variant të konsoliduar të prospektit të shtuar, kur një variant i tillë i konsoliduar është i nevojshëm për të siguruar që informacioni i dhënë në prospekt të jetë i kuptueshëm. Kjo kërkesë konsiderohet si kërkesë për informacion shtesë, sipas nenit 21 pika 12 të kësaj rregulloreje.

KREU VII

RREGULLA PËR EMETUESIT E VENDOSUR JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 29

Oferta e titujve drejtuar publikut apo pranimi për tregtim në një treg të rregulluar, që bëhet përmes prospektit të hartuar në përputhje me këtë rregullore

1. Kur një emetues i vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kërkon të ofrojë tituj për publikun apo të kërkojë leje për të tregtuar titujt në një treg të rregulluar, përcaktuar në bazë të një prospekti të hartuar në përputhje me ligjet e vendit të tij të origjinës, në mbështetje të nenit 247 të Ligjit, Autoriteti njeh prospektin e paraqitur nga emetuesi, pasi është miratuar më parë nga autoriteti kompetent i vendit të tij të origjinës. Prospekti duhet të jetë i barasvlershëm me kërkesat e parashikuara në Ligj dhe në këtë rregullore.
2. Pas miratimit të prospektit në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ai përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që parashikon prospekti, në bazë të kësaj rregulloreje dhe prospekti dhe emetuesi i vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë u nënshtrohen të gjitha dispozitave të kësaj rregulloreje, nën mbikëqyrjen e Autoritetit.

Neni 30

Oferta e titujve për publikun dhe pranimi për tregtim në një treg të rregulluar i kryer në bazë të prospektit të hartuar në përputhje me ligjet e vendit të origjinës

1. Kur emetuesi është i vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ai mund të miratojë një prospekt për ofrimin e titujve publikut dhe për pranimin për tregim në një treg të rregulluar, hartuar në përputhje dhe që është objekt i ligjeve të vendit të origjinës së emetuesit, me kusht që:
 - a) kërkesat lidhur me informacionin që vendos vendi i origjinës janë të barasvlershme me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe në përputhje me nenin 247, pika 1, shkronja (b), e Ligjit dhe
 - b) autoriteti kompetent i vendit të origjinës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin, në mbështetje të nenit 247, pika 1, shkronja (c) dhe pika 2, shkronja (a) e Ligjit.

2. Në rastin e një oferte për publikun dhe pranimit për tregtim në një treg të rregulluar nga një emetues i vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gjejnë zbatim kërkesat e parashikuara në nenin 247 të Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
3. Në rastin e një oferte për publikun dhe pranimit për tregtim në një treg të rregulluar nga një emetues i vendosur në një nga vendet anëtare të Bashkimit Europian, kërkesat e nenit 247, pika 1, shkronja (b) dhe (c) të Ligjit konsiderohen të përmbushura.

Neni 31

Bashkëpunimi me vendet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Për qëllimet e neneve 29 dhe 30, autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës lidhin marrëveshje për shkëmbim informacioni me Autoritetin, në bazë të marrëveshjes me IOSCO-n, në përputhje me nenin 247, pika 1 shkronja (c) dhe pika 2, shkronja (a) e Ligjit dhe zbatojnë detyrimet që lindin sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje në vendin e origjinës. Këto marrëveshje bashkëpunimi sigurojnë të pakën një shkëmbim efikas informacioni, që bën të mundur përmbushjen e detyrave nga Autoriteti, në përputhje me Ligjin dhe këtë rregullore.
2. Autoriteti lidh marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të origjinës, vetëm kur informacioni i deklaruar u nënshtrohet garancive të sekretit profesional, që janë të paktën të barasvlershme me ato që parashikon neni 32 i kësaj rregulloreje. Ky shkëmbim informacioni duhet të jetë në funksion të kryerjes së detyrave të Autoritetit.

Neni 32

Konfidencialiteti

1. I gjithë informacioni i shkëmbyer midis autoriteteve kompetente në vendin e origjinës dhe Autoritetit të përcaktuar në këtë rregullore, që ka të bëjë me kushtet operative ose të biznesit dhe çështje të tjera ekonomike ose personale konsiderohet konfidencial, si dhe u nënshtrohet kriterëve të sekretit profesional, me përjashtim të rastit kur autoriteti kompetent deklaron në momentin e komunikimit se informacioni mund të jepet ose kur dhënia e informacionit është e nevojshme në procedura gjyqësore.
2. Të gjithë personat që punojnë ose kanë punuar për autoritetin kompetent në vendin e origjinës dhe për Autoritetin ose për palë të treta të cilave autoriteti kompetent i vendit të origjinës dhe Autoriteti u kanë deleguar kompetencat janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin profesional. Informacioni që mbulohet nga sekreti profesional nuk mund t'i jepet asnjë individ apo autoriteti tjetër, me përjashtim të rasteve që parashikohen në dispozitat e legjislationit kombëtar.

KREU VIII
SANKSIONE ADMINISTRATIVE DHE MASA TË TJERA ADMINISTRATIVE

Neni 33

Ushtrimi i kompetencave mbikëqyrëse dhe kompetencave për vendosjen e sanksioneve

Gjatë përcaktimit të llojit dhe shkallës së sanksioneve administrative dhe masave të tjera administrative, në përputhje me ligjin, Autoriteti vlerëson të gjitha rrethanat përkatëse.

KREU IX
REALIZIMI I OFERTËS DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 34

Shuma minimale e realizimit/përmbushjes së ofertës

1. Emetuesi përcakton në prospekt shumën minimale të nënshkrimit të titujve, për të cilën oferta drejtuar publikut dhe/ose pranuar për tregtim në një treg të rregulluar do konsiderohet e realizuar/përmbushur.
2. Në rast të mosplotësimit të pikës 1 e këtij neni, ofrimi publik apo pranimi për tregtim konsiderohet i parealizuar dhe vlera e nënshkruar i kthehet investitorit.

Neni 35

Emërimi i përfaqësuesit të obligacion-mbajtësve

1. Brenda 3-muajve nga mbyllja e ofertës, emetuesi njofton të gjithë obligacion-mbajtësit për të drejtën e tyre për zgjedhjen e një përfaqësuesi, i cili do të jetë përgjegjës për përfaqësimin e interesave të tyre dhe për datën e mbledhjes së obligacion-mbajtësve.
2. Brenda 6-muajve nga mbyllja e ofertës, mbledhja e obligacion-mbajtësve cakton përfaqësuesin.
3. Emetuesi njofton Autoritetin mbi përfaqësuesin e obligacionmbajtësve brenda 10 ditë pune nga caktimi apo emërimi i përfaqësuesit.
4. Në funksionin e përfaqësuesit të obligacion-mbajtësit mund të jetë: një shoqëri komisionere, bankë që ofron shërbime investimi, shoqëri me objekt veprimtarie konsulencë juridike, konsulencë financiare apo shoqëri e auditimit ligjor. Nuk mund të zgjidhen si përfaqësues të obligacion-mbajtësve administratorët, personat apo subjektet që kanë lidhje të ngushta apo konflikt interesi me emetuesin.

Neni 36

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**SHTOJCË I – INFORMACIONI DHE FORMATI STANDARD I PROSPEKTIT TË
PARAQITUR SI DOKUMENT I VETËM**
[Identiteti dhe të dhënat e kontaktit të emetuesit, përfshi numrin e identitetit si person
juridik (NIPT)]

[Identiteti dhe të dhënat e kontaktit të Autoritetit ose autoritetit kompetent të vendit të
originës që miraton prospektin]

[Lloji dhe klasa e titujve]

[Numri kombëtar ose ndërkombëtar i identifikimit të titullit – të përfshihet pas marrjes
dhe paraqitjes tek Autoriteti]

[Norma e interesit, nëse gjen zbatim]

[PERIUDHA E OFERTËS]

[Data e miratimit të prospektit – të përfshihet pas miratimit nga Autoriteti]

INVESTIMI NË KËTË TITULL SHOQËROHET ME RREZIQE. FAKTORËT E RREZIKUT TË EMETUESIT DHE TË TITULLIT PËRSHKRUEHEN NË KËTË PROSPEKT DHE DUHEN LEXUAR ME KUJDES.

KREU I – PËRMBLEDHJA

RUBRIKA 1 – Hyrje dhe paralajmërime

DEKLARATA E EMETUESIT

Me besim të plotë dhe bazuar në gjithë informacionin dhe të dhënat e paraqitura në prospekt, deklarojmë se i gjithë informacioni dhe të dhënat që gjenden në këtë prospekt përbëjnë paraqitjen e plotë të aktiveve dhe pasiveve, fitimeve dhe humbjeve, situatës financiare dhe veprimtarive reale të emetuesit, të të drejtave që lidhen me titullin që do t'i ofrohet publikut dhe do të pranohet për t'u tregtuar në një treg të rregulluar dhe se i gjithë informacioni dhe data e paraqitur këtu janë të sakta e korrekte dhe se nuk është hequr asnjë informacion apo të dhëna që ndikojnë në saktësinë dhe tërësinë e informacionit,

nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i emetuesit]

NJOFTIME TË RËNDËSISHME PËR INVESTITORIN

Ky prospekt përmban informacione të rëndësishme mbi emetuesin dhe titullin. Prospekti përshkruan, gjithashtu, rreziqet që shoqërojnë emetuesin dhe rreziqet shoqëruese të investimit në tituj.

Rekomandohet të lexoni dhe të kuptoni plotësisht përmbajtjen e të gjithë prospektit, përpara se të merrni një vendim për të investuar në tituj. Për rrjedhojë, kjo përmbledhje duhet lexuar vetëm si hyrje.

PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN QË PËRMBAN PROSPEKTI

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionin dhe të dhënat që përmban ky prospekt. Informacionet janë në përputhje me faktet dhe nuk lënë jashtë asnjë informacion që do të cenonte vlerën e tij. Kur përdoren informacione nga burimet e palëve të treta, këto informacione riprodhohen në mënyrë të saktë dhe emetuesi është në gjendje të shpjegojë qartësisht informacionin e publikuar nga kjo palë e tretë, dhe nuk lihet jashtë asnjë fakt që do ta bënte informacionin e riprodhuar të pasaktë apo çorientues.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare verifikon vetëm nëse prospekti përmban të gjithë informacionin e përcaktuar në Ligjin Nr. 62/2020, 'Për tregjet e kapitalit' dhe kërkesat rregullatore sa i përket plotësisë, njëtrajtshmërisë dhe kuptueshmërisë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk verifikon nëse informacioni që përmban ky prospekt është i saktë dhe korrekt.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk jep rekomandime për askënd në lidhje me përshtatshmërinë e investimit në tituj. Çdo investitor është përgjegjës për vendimin e tij bazuar në informacionet që përmban ky prospekt dhe, nëse është i pasigurt për ndonjë investim, duhet të këshillohet me një profesionist.

RUBRIKA 2 – Informacione kryesore rreth emetuesit

Pika 1	Emetuesi i titujve
Pika 1.1	Selia qendrore dhe personaliteti juridik i emetuesit, NIPT-i, ligji në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë dhe vendi i themelimit
Pika 1.2	Veprimtaritë kryesore të emetuesit
Pika 1.3	Aksionarët me pjesëmarrje të lartë, duke specifikuar nëse janë nën pronësi ose kontroll të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë dhe nga kush
Pika 1.4	Identiteti i drejtorëve kryesorë administrativë
Pika 1.5	Identiteti i audituesve të tij ligjorë
Pika 2	Informacion kryesor financiar për tri vitet e shkuara (ose për një afat më të shkurtër, në varësi të krijimit të emetuesit) (Të dhëna të bilancit të fund vitit)
Pika 3	Rreziqet kryesore të emetuesit

RUBRIKA 3 – Tiparet kryesore të titujve

Pika 1	Tiparet kryesore të titujve
--------	-----------------------------

Pika 1.1	Lloji, klasa dhe numri ndërkombëtar ose kombëtar i identifikimit i emetuesit – do të përfshihet pasi të merret dhe do i paraqitet Autoritetit
Pika 1.2	Monedha, prerja, vlera nominale, numri i titujve dhe afati i maturimit i titujve – sipas rastit
Pika 1.3	Të drejtat që lidhen me titullin e emetuesit
Pika 1.4	Përparësia relative e titujve në strukturën e kapitalit të emetuesit në rast falimentimi, përfshi, kur është nevoja, informacione për shkallën e nënrenditjes së titujve të emetuesit
Pika 1.5	Kufizimet për transferimin lirisht të titujve të emetuesit
Pika 1.6	Sipas rastit, politikën e dividendit dhe pagesave të emetuesit
Pika 2	Tregtimi i titujve (Përcaktimi i tregut të rregulluar ku tregtohen titujt)
Pika 3	Garancitë që lidhen me titujt (nëse ka)
Pika 3.1	Përshkrimi i natyrës dhe objektit të garancisë
Pika 3.2.	Përshkrim i shkurtër i garantit, përfshi NIPT-in e tij
Pika 3.3	Informacioni kryesor financiar përkatës për qëllime vlerësimi të aftësisë së garantit për të përmbushur angazhimet e tij, sipas garancisë
Pika 3.4	Përshkrim i shkurtër i faktorëve më thelbësorë të rrezikut që lidhen me garantin, që përfshihen në prospekt
Pika 4	Rreziqet kryesore që janë specifike për titujt

RUBRIKA 4 – Informacione kryesore rreth titujve

Pika 1	<p>Kushtet dhe kalendari i ofertës së titujve, përfshi</p> <ul style="list-style-type: none"> • kriteret e përgjithshme • kushtet dhe kalendari i pritshëm i ofertës • detaje të pranimit për t'u tregtuar në një treg të rregulluar • planin e shpërndarjes
--------	--

	<ul style="list-style-type: none"> • sasinë dhe përqindjen e rezultatit të menjëhershëm të ofertës (sipas rastit) • vlerësimin e shpenzimeve të përgjithshme të emetimit, përfshi vlerësimin e përafërt të shpenzimeve që i ngarkohen investorit
Pika 2	<p>Arsyeja e hartimit të prospektit</p> <p>Përshkrim i shkurtër i arsyeve të ofertës dhe, kur është nevoja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdorimi dhe vlera e flukseve monetare neto nga emetimi • të dhëna nëse oferta është objekt i një marrëveshjeje nënshkrimi sipas një angazhimi të përcaktuar, duke përmendur të gjitha pjesët që nuk mbulohen nga kjo marrëveshje • të dhëna për konfliktet materiale të interesit që lidhen me ofertën apo pranimin për t'u tregtuar në një treg të rregulluar

KREU II – INFORMACION RRETH EMETUESIT

RUBRIKA 1	PERSONAT PËRGJEGJËS, INFORMACIONI NGA PALËT E TRETA, RAPORTET E EKSPERTËVE DHE MIRATIMI NGA AUTORITETI KOMPETENT
Pika 1.1	Identifikoni të gjithë personat përgjegjës për informacionin ose pjesë të tij, që paraqitet në prospekt, duke shënuar, për rastin e dytë, cilat janë këto pjesë. Në rastin e personave fizikë, përfshi anëtarë të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit, shënoni emrin dhe funksionin e personit; në rastin e personave juridikë, shënoni emrin dhe adresën e regjistruar të tyre.
Pika 1.2	Një deklaratë nga personat përgjegjës për prospektin që, në dijeninë e tyre, informacioni që përfshihet në prospekt është në përputhje me faktet. Sipas rastit, një deklaratë nga personat përgjegjës për pjesë të caktuara të prospektit që, në dijeninë e tyre, informacioni që përfshihet në ato pjesë të prospektit, për të cilin ata janë përgjegjës, është në përputhje me faktet dhe ato pjesë të dokumentit të regjistrimit nuk lënë jashtë asnjë informacion që mund të cenojë kuptimin e tyre.
Pika 1.3	Kur një deklaratë a raport që i atribuohet një personi si ekspert do përfshihet në prospekt, jepni të dhënat e personit për emrin, adresën e biznesit, kualifikimet dhe interesin material të emetuesit, nëse ka. Nëse deklarata ose raporti janë hartuar me kërkesë të emetuesit, shënoni që deklarata ose raporti është përfshirë në prospekt me miratimin e personit, i cili ka autorizuar përmbajtjen e asaj pjese të prospektit.
Pika 1.4	Kur informacioni është marrë nga palë të treta, konfirmoni që ky informacion është riprodhuar saktësisht dhe, për aq sa emetuesi ka dijeni apo është në gjendje të vërtetojë nga informacioni i publikuar nga kjo palë e tretë, nuk është hequr asnjë fakt që do ta bënte informacionin e riprodhuar të pasaktë ose çorientues. Përveç kësaj, identifikoni burimin/burimet e informacionit.
RUBRIKA 2	AUDITUESIT LIGJORË
Pika 2.1	Emrat dhe adresat e audituesve të emetuesit për periudhën që mbulon informacioni historik financiar (së bashku me licencën apo anëtarësinë e tyre në institucionin profesional përkatës).
Pika 2.2	Jepni hollësi, nëse janë të rëndësishme, nëse audituesit kanë dhënë dorëheqjen, janë shkarkuar ose nuk janë riemëruar gjatë periudhës që mbulon informacioni historik financiar.

RUBRIKA 3	FAKTORËT E RREZIKUT
Pika 3.1	Një përshkrim i rreziqeve materiale specifike për emetuesin në një numër të kufizuar kategorish, në një rubrikë të titulluar, ‘Faktorët e rrezikut’. Në secilën kategori, të parat do të renditen rreziqet më të rëndësishme, sipas vlerësimit të kryer nga emetuesi, duke marrë parasysh ndikimin negativ tek emetuesi dhe gjasat që ato të ndodhin. Rreziqet do të mbështeten nga përmbajtja e informacionit për emetuesin.
RUBRIKA 4	INFORMACION RRETH EMETUESIT
Pika 4.1	Emri juridik dhe tregtar i emetuesit.
Pika 4.2	Vendi i regjistrimit të emetuesit, numri i tij i regjistrimit dhe numri i identifikimit si subjekt juridik (NIPT).
Pika 4.3	Data e themelimit dhe kohëzgjatja e emetuesit, me përjashtim kur është periudhë e pacaktuar.
Pika 4.4	Selia qendrore dhe personaliteti juridik, legjislacioni në bazë të të cilit vepron emetuesi, vendi i themelimit, adresa, numri i telefonit të adresës së regjistruar (ose vendit kryesor të aktivitetit, nëse ndryshon nga selia e regjistruar) dhe faja e internetit të emetuesit, nëse ka, me një paralajmërim se informacioni në faqen në internet nuk është pjesë e prospektit.
RUBRIKA 5	PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I AKTIVITETIT
Pika 5.1	Veprimtaritë kryesore
Pika 5.1.1	Përshkrimi i faktorëve kryesorë për natyrën e operacioneve të emetuesit dhe veprimtaritë e tij kryesore, duke përcaktuar kategoritë kryesore të produkteve të shitura dhe/ose shërbimeve të kryera për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike financiare;
Pika 5.1.2	Një përshkrim i çdo produkti dhe/ose shërbimi të ri të rëndësishëm të futur rishtazi dhe, në masën që zhvillimi i këtyre produkteve apo shërbimeve të reja është bërë publik, të tregohet statusi i zhvillimit të tyre.
Pika 5.2	Tregjet kryesore Një përshkrim i tregjeve kryesore, në të cilat konkurren emetuesi, përfshirë një pasqyrë të të ardhurave të përgjithshme sipas segmentit të tregut të produktit dhe atij gjeografik për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike financiare.

Pika 5.3	Ngjarjet e rëndësishme në zhvillimin e aktivitetit të emetuesit.
Pika 5.4	Strategjia dhe objektivat Një përshkrim i strategjisë dhe objektivave tregtare, financiare e jofinanciare (nëse ka) të emetuesit. Ky përshkrim merr parasysh sfidat dhe perspektivat e ardhshme të emetuesit.
Pika 5.5	Nëse janë të një rëndësie materiale për veprimtarinë tregtare ose fitimet e emetuesit, informacione përmbledhëse për nivelin e varësisë së emetuesit nga patenta ose licenca, kontrata industriale, tregtare ose financiare, ose procese të reja prodhimi.
Pika 5.6	Burimin e çdo deklaratë të bërë nga emetuesi për pozicionin e tij konkurrues në treg.
Pika 5.7	Investimet
Pika 5.7.1	Një përshkrim (përfshi vlerën) të investimeve kryesore të emetuesit për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike financiare deri më sot.
Pika 5.7.2	Një përshkrim të investimeve kryesore të emetuesit, të cilat janë në proces ose për të cilat janë marrë përsipër angazhime, përfshirë shpërndarjen gjeografike të këtyre investimeve (brenda dhe jashtë vendit) dhe mënyrën e financimit (të brendshëm ose të jashtëm).
Pika 5.7.3	Informacion në lidhje me sipërmarrjet e përbashkëta dhe shoqëritë ku emetuesi zotëron një pjesëmarrje të tillë në kapital, që mund të ketë një efekt të konsiderueshëm në vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve të veta, pozicionit financiar ose fitimit dhe humbjes.
Pika 5.7.4	Një përshkrim i çdo problemi mjedisor, që mund të ndikojë në përdorimin që u bën emetuesi aktiveve afatgjata materiale.
RUBRIKA 6	STRUKTURA ORGANIZATIVE
Pika 6.1	Nëse emetuesi është pjesë e një grupi duhet të jepet një përshkrim i shkurtër i grupit dhe i pozicionit të emetuesit brenda grupit. Kjo mund të jetë në formën e një diagrami të strukturës organizative ose mund të shoqërohet me një diagram të tillë, nëse kjo ndihmon në sqarimin e strukturës.
Pika 6.2	Një listë e shoqërive të kontrolluara më të rëndësishme, përfshirë emrin, vendin e themelimit ose vendin e selisë, pjesën e interesit të pronësisë dhe, nëse është e ndryshme, të drejtat e votës që zotëron.

RUBRIKA 7	VLERËSIMI OPERATIV DHE FINANCIAR
Pika 7.1	Gjendja financiare
Pika 7.1.1	<p>Për aq sa nuk trajtohet diku tjetër dhe për aq sa është e nevojshme për të kuptuar aktivitetin tregtar të emetuesit në tërësi, të jepet një vlerësim i drejtë i zhvillimit dhe rezultateve të aktivitetit tregtar të emetuesit dhe gjendjes së tij financiare për çdo vit dhe për periudhat e ndërmjetme, për të cilat kërkohen të dhëna historike financiare, përfshi shkaqet e ndryshimeve kryesore.</p> <p>Ky vlerësim është një analizë e drejtpeshuar dhe gjithëpërfshirëse e zhvillimit dhe rezultateve të aktivitetit tregtar dhe gjendjes financiare të emetuesit, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e aktivitetit të tij.</p> <p>Për aq sa është e nevojshme për të kuptuar zhvillimin, rezultatet ose gjendjen financiare të emetuesit, analiza përmban Treguesit Kryesorë të Performancës financiare dhe, kur duhet, edhe Jofinanciare që janë të rëndësishme për veprimtarinë tregtare përkatëse. Kur është nevojë, analiza përfshin referenca dhe shpjegime shtesë lidhur me vlerat e raportuara në pasqyrat financiare vjetore.</p>
Pika 7.1.2	Për aq sa nuk trajtohet diku tjetër dhe për aq sa është e nevojshme për të kuptuar veprimtarinë tregtare të emetuesit në tërësi, vlerësimi përmban po ashtu të dhëna rreth zhvillimeve dhe aktiviteteve të mundshme të emetuesit në të ardhmen në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit.
Pika 7.2	Rezultatet e aktivitetit
Pika 7.2.1	Informacion për faktorët e rëndësishëm, përfshirë ngjarje të pazakonta, të rralla ose zhvillime të reja, që ndikojnë në mënyrë thelbësore të ardhurat e emetuesit nga aktiviteti tregtar, duke përcaktuar masën me të cilën preken të ardhurat.
Pika 7.2.2	Kur të dhënat financiare historike paraqesin ndryshime thelbësore në të ardhurat ose shitjet neto, bëni një argumentim përshkrues të arsyeve për këto ndryshime.
RUBRIKA 8	BURIMET E KAPITALIT
Pika 8.1	Informacion për burimet e kapitalit të emetuesit (afatshkurtra dhe afatgjata).
Pika 8.2	Një shpjegim të burimeve dhe vlerave dhe një përshkrim të flukseve monetare të emetuesit.
Pika 8.3	Informacion për kërkesat për huamarrjen dhe strukturën e financimit të emetuesit.

Pika 8.4	Informacion për çdo kufizim për përdorimin e burimeve të kapitalit, që kanë ndikuar në mënyrë thelbësore ose mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në veprimtaritë tregtare të emetuesit.
Pika 8.5	Informacion për burimet e parashikuara të financimit, që janë të nevojshme për përmbushjen e angazhimeve të përcaktuara në pikën 5.7.2.
RUBRIKA 9	MJEDISI RREGULLATOR
Pika 9.1	Një përshkrim i mjedisit rregullator në të cilin ushtron veprimtari emetuesi dhe që mund të ketë ndikim të rëndësishëm në veprimtarinë e tij, së bashku me informacionin për çdo politikë qeveritare, ekonomike, fiskale, monetare ose politike ose faktorë, që kanë ndikuar në mënyrë thelbësore ose mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në aktivitetin tregtar të emetuesi.
RUBRIKA 10	INFORMACION PËR PRIRJET
Pika 10.1	Një përshkrim të prirjeve më të rëndësishme të kohëve të fundit sa i takon prodhimin, shitjes së produktit të gatshëm/shërbimeve, kostove dhe çmimeve të shitjes, që nga mbyllja e vitit të fundit financiar deri në datën e prospektit dhe çdo ndryshimi të konsiderueshëm në ecurinë financiare të grupit, që nga mbyllja e periudhës së fundit financiare, për të cilën është publikuar informacioni financiar, deri në datën e prospektit ose paraqitje e një deklaratë përkatëse negative.
Pika 10.2	Informacion për çdo prirje, pasiguri, kërkesë, angazhim ose ngjarje të ditur, të cilat ka mundësi të arsyeshme të kenë një ndikim thelbësor në perspektivat e emetuesit të paktën për vitin aktual financiar.
RUBRIKA 11	PARASHIKIMET OSE VLERËSIMET E FITIMEVE
Pika 11.1	Kur emetuesi ka publikuar një parashikim të fitimit ose një vlerësim të fitimit (që është ende i përcaktuar dhe i vlefshëm), ky parashikim ose vlerësim duhet të përfshihet në prospekt. Nëse është publikuar një parashikim fitimi ose një vlerësim fitimi i përcaktuar, por që nuk është më i vlefshëm, atëherë, jepni informacionin përkatës dhe shpjegoni përse parashikimi ose vlerësimi nuk është më i vlefshëm. Ky parashikim ose vlerësim i përcaktuar nuk u nënshtrohet kërkesave të pikës 11.2 dhe 11.3.
Pika 11.2	Kur emetuesi vendos të përfshijë një parashikim të ri të fitimit ose një vlerësim të ri të fitimit, ose një parashikim fitimi të publikuar më parë, ose një vlerësim fitimi të publikuar më parë, në bazë të pikës 11.1, parashikimi ose vlerësimi i fitimit duhet të jetë i qartë, të mos lërë vend për keqkuptime dhe të shoqërohet nga një deklaratë, e cila përcakton supozimet kryesore mbi të cilat emetuesi ka mbështetur parashikimin ose vlerësimin.

Pika 11.3	Prospekti përfshin një deklaratë se parashikimi ose vlerësimi i fitimit është përpiluar mbi një bazë që është e krahasueshme me të dhënat historike financiare dhe në përputhje me politikat kontabël të emetuesit.
RUBRIKA 12	ORGANET ADMINISTRATIVE, DREJTUESE DHE MBIKËQYRËSE DHE DREJTUESIT E LARTË
Pika 12.1	<p>Emrat, adresat dhe funksionet që mbajnë pranë emetuesit, si edhe informacion për veprimtaritë kryesore të kryera jashtë emetuesit, kur këto janë të rëndësishme për emetuesin, për personat e mëposhtëm:</p> <p>(a) anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse;</p> <p>(b) ortakë me përgjegjësi të pakufizuar, në rast ortakërie me përgjegjësi të kufizuar me kapital aksionar;</p> <p>(c) themeluesit, nëse emetuesi është themeluar prej më pak se pesë vjetëve;</p> <p>(d) drejtuesit e lartë që janë të aftë të përcaktojnë se emetuesi ka përvojën dhe ekspertizën e duhur për menaxhimin e aktivitetit tregtar të emetuesit.</p> <p>Hollësi mbi natyrën e marrëdhënieve familjare midis çdonjërit prej personave të përmendur në pikat (a) deri në (d).</p> <p>Për çdo anëtar të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit dhe për personat e përmendur në pikat (b) dhe (d) të kësaj pike do të jepen të dhëna për ekspertizën dhe përvojën përkatëse drejtuese, si dhe informacioni në vijim:</p> <p>(a) emrat e të gjitha shoqërive tregtare dhe ortakërive ku këta persona kanë shërbyer si anëtarë të organeve administrative, drejtuese apo mbikëqyrëse ose si ortakë gjatë pesë viteve të mëparshme, përfshi faktin nëse individi vazhdon ose jo të jetë anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse apo ortak. Nuk është e nevojshme të renditen të gjitha shoqëritë e kontrolluara të emetuesit ku personi është gjithashtu anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse;</p> <p>(b) të dhëna nëse është dënuar për vepra mashtrimi të paktën brenda pesë viteve të fundit;</p> <p>(c) të dhëna lidhur me falimente, administrim ligjor, likuidime apo shoqëri të vendosura nën administrim në raport me personat e përkthuar në shkronjat (a) dhe (d) të pikës së parë, të cilët kanë vepruar në një ose më shumë prej këtyre funksioneve të paktën brenda pesë viteve të fundit;</p> <p>(d) të dhëna për kallëzime për kryerjen e veprës penale dhe/ose sanksione të vendosura kundër këtyre personave nga autoritetet ligjore ose rregullatore (përfshi urdhrat e përcaktuar profesionalë dhe nëse janë refuzuar me vendim gjykatë të veprojnë si anëtarë të organeve administrative, drejtuese apo mbikëqyrëse të një emetuesi apo që të kryejnë funksione në menaxhimin apo drejtimin e veprimtarive të një emetuesi për të paktën pesë vitet e fundit.</p> <p>Nëse nuk ka informacion të tillë nga këto që kërkohen, duhet bërë një</p>

	deklaratë për këtë qëllim.
Pika 12.2	<p>Konfliktet e interesit të organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse dhe drejtuesve të lartë</p> <p>Konfliktet e mundshme të interesit midis detyrave ndaj emetuesit të personave të përmendur në pikën 12.1 dhe interesave të tyre personale dhe/ose detyrave të tjera duhet të përcaktohen qartë. Nëse nuk ka të tilla konflikte, duhet bërë një deklaratë për këtë qëllim.</p> <p>Çdo marrëveshje ose mirëkuptim me aksionarët kryesorë, investuesit, furnitorët apo të tjerë, sipas të cilave personat e përmendur në pikën 12.1 janë zgjedhur si anëtarë të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse apo si drejtues të lartë.</p> <p>Të dhëna rreth kufizimeve për të cilat është rënë dakord me personat e përmendur në pikën 12.1 mbi heqjen dorë brenda një afati të caktuar nga kontrolli i titujve të emetuesit.</p>
RUBRIKA 13	SHPËRBLIMI DHE PËRFITIMET
	Në lidhje me vitin e mbyllur financiar, për personat që përmenden në pikat (a) dhe (d) paragrafit të parë të pikës 12.1
Pika 13.1	<p>Vlerat e shpërblimit të paguar (përfshi çdo kompensim të kushtëzuar ose të shtyrë) dhe përfitimet në natyrë, që u jepen personave të tillë nga emetuesi dhe shoqëritë e tij të kontrolluara për shërbimet që secili prej këtyre personave i ofron në të gjitha funksionet emetuesit dhe shoqërive e tij të kontrolluara.</p> <p>Ky informacion duhet të jepet në mënyrë individuale, përveç rastit kur dhënia e informacionit në mënyrë individuale nuk kërkohet në vendin e origjinës së emetuesit dhe nuk është bërë publike në asnjë mënyrë tjetër nga emetuesi.</p>
Pika 13.2	Vlerat e përgjithshme të vëna rezervë ose të akumuluar nga emetuesi ose shoqëritë e tij të kontrolluara për pensione pleqërie ose për përfitime të ngjashme.
RUBRIKA 14	PRAKTIKAT E KËSHILLAVE
	Në lidhje me vitin e mbyllur financiar të emetuesit, nëse nuk është specifikuar ndryshe, për personat që përmenden në pikat (a) dhe (d) paragrafit të parë të pikës 12.1:
Pika 14.1	Data e përfundimit të mandatit aktual, nëse ka, dhe periudhën gjatë së cilës personi ka shërbyer në këtë funksion.
Pika 14.2	Informacion rreth kontratave të shërbimit të lidhura midis anëtarëve të

	këshillave administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse dhe emetuesin ose ndonjë prej shoqërive të kontrolluara nga emetuesi, ku parashikohen përfitime nga zgjidhja e marrëdhënieve të punës ose deklaratën përkatëse për këtë qëllim që nuk ka të tilla përfitime.
Pika 14.3	Informacion rreth komitetit të auditimit dhe komitetit të pagave të emetuesit, përfshi emrat e anëtarëve të komitetit dhe një përmbledhje e rregullave në bazë të të cilave vepron komiteti.
Pika 14.4	Një deklaratë nëse emetuesi është ose jo në përputhshmëri me regjimin/regjimet e drejtimit të brendshëm të shoqërisë/shoqërive tregtare. Në rast se emetuesi nuk është në përputhje me një regjim të tillë, duhet bërë një deklaratë për këtë qëllim, shoqëruar me një shpjegim të arsyeve pse emetuesi nuk vepron në përputhje me këtë regjim.
Pika 14.5	Efektet e mundshme thelbësore në drejtimin e shoqërisë tregtare, përfshi ndryshimet e ardhshme në përbërjen e këshillit dhe të komitetit (nëse për këtë është marrë tashmë vendim nga këshilli dhe/ose nga asambleja e aksionarëve).
RUBRIKA 15	PUNËMARRËSIT
Pika 15.1	Informacion për numrin e punëmarrësve në fund të periudhës ose mesatarja për secilin vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat financiare historike deri në datën e prospektit (dhe ndryshimet e këtij numri, nëse është domethënës) dhe, nëse e mundur dhe me rëndësi, një informacion të detajuar për numrin e personave të punësuar sipas kategorive kryesore të veprimtarisë dhe vendndodhjes gjeografike. Nëse emetuesi punëson një numër të konsiderueshëm punonjësish të përkohshëm, përfshi informacion mbi numrin e punonjësve të përkohshëm gjatë vitit të fundit financiar.
Pika 15.2	Pjesëmarrjet në kapital dhe mundësitë për aksione Për çdo person të përmendur në pikat (a) dhe (d) të paragrafit të parë të pikës 12.1, të jepet informacionin për aksionet që zotërojnë apo mundësi për të tilla aksione të emetuesit në datën më të fundit të mundshme.
Pika 15.3	Përshkrim i marrëveshjeve për përfshirjen e punonjësve në kapitalin e emetuesit.
RUBRIKA 16	AKSIONARËT ME PJESËMARRJE TË LARTË
Pika 16.1	Për sa ka dijeni emetuesi, duhet të jepet emri i çdo personi, që nuk është anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse, i cili, drejtpërdrejt ose tërthorazi, zotëron interes në kapitalin ose të drejtat e votës së emetuesit, që duhet njoftuar në bazë të ligjit, së bashku me informacionin për vlerën e interesit të secilit prej këtyre personave në datën e prospektit

	ose, nëse nuk ka persona të tillë, të lëshohet një deklaratë për këtë qëllim që nuk ka asnjë person të tillë.
Pika 16.2	Nëse aksionarët me pjesëmarrje të lartë në kapitalin e emetuesit kanë ose jo të drejta të ndryshme vote ose një deklaratë për këtë qëllim që nuk ka të tilla të drejta vote.
Pika 16.3	Për sa ka dijeni emetuesi, të deklarohet nëse emetuesi është drejtpërdrejt ose tërthorazi nën pronësinë ose kontrollin e të tjerëve dhe të kujt, si dhe të përshkruhet natyra e kontrollit dhe masat që janë marrë për të siguruar që nuk do të ketë abuzime me këtë kontroll.
Pika 16.4	Përshkrim i marrëveshjeve, për sa ka dijeni emetuesi, zbatimi i të cilave mund të sjellë më pas ndryshim të kontrollit të emetuesit.
RUBRIKA 17	TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA
Pika 17.1	<p>Duhet paraqitur, në përputhje me standardin përkatës, të dhëna për transaksione të kryera nga emetuesi me palë të lidhura gjatë periudhës së mbuluar nga të dhënat e pasqyrave financiare historike deri në datën e prospektit.</p> <p>Nëse këto standarde nuk zbatohen për emetuesin, duhet paraqitur informacioni në vijim:</p> <p>(a) natyra dhe efektet e çdo transaksioni që është, më vete ose në tërësinë e tij, me rëndësi për emetuesin. Kur transaksionet me palët e lidhura nuk janë kryer sipas kushteve të zakonshme të tregut, të jepet një shpjegim përse këto transaksione nuk janë kryer me kushte të zakonshme të tregut. Në rastin e kredive të pashlyera, përfshi garancitë e çdo lloji, të bëhet e ditur shuma e detyrimit të mbetur;</p> <p>(b) shuma ose përqindja që përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura në raport me xhiron e emetuesit.</p>
RUBRIKA 18	TË DHËNAT FINANCIARE MBI AKTIVET, PASIVET, GJENDJEN FINANCIARE DHE FITIMET E HUMBJET E EMETUESIT
Pika 18.1	Të dhënat historike financiare
Pika 18.1.1	Informacion financiar historik i audituar që mbulon tre vitet fundit financiare, (ose një periudhë më të shkurtër, gjatë së cilës emetuesi ushtron veprimtari) dhe raportin e auditimit për secilin vit, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), nëse është rasti.
Pika 18.1.2	Ndryshimin e datës së periudhës kontabël të raportimit Nëse emetuesi e ka ndryshuar datën e periudhës kontabël të raportimit gjatë

	<p>periudhës për të cilën kërkohen të dhënat historike financiare, informacioni historik i audituar mbulon të paktën [36] muaj ose të gjithë periudhën gjatë së cilës emetuesi ka ushtruar veprimtarinë, cilado qoftë më e shkurtër.</p>
Pika 18.1.3	<p>Të dhënat financiare të audituara duhet të përfshijnë të paktën bilancin, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e fluksit të parasë dhe politikat kontabël e shënimet shpjeguese.</p>
Pika 18.1.4	<p>Vjetërsia e informacionit financiar</p> <p>Bilanci i vitit të fundit të të dhënave financiare të audituara nuk mund të jetë më i vjetër sesa si vijon:</p> <p>(a) 18 muaj nga data e prospektit, nëse emetuesi përfshin pasqyra të ndërmjetme financiare të audituara;</p> <p>(b) 16 muaj nga data e regjistrimit të dokumentit, nëse emetuesi përfshin në prospektin pasqyra të ndërmjetme financiare të paaudituar.</p>
Pika 18.2	<p>Të dhënat e përkohshme financiare dhe të tjera</p>
Pika 18.2.1	<p>Nëse emetuesi ka publikuar informacion financiar mbi baza tremujore ose gjashtëmujore, që nga data e pasqyrave financiare të fundit të audituara, ato duhet të përfshihen në prospekt. Nëse informacioni financiar tremujor ose gjashtëmujor është audituar ose është kontrolluar, duhet të përfshihet edhe raporti i auditimit ose raporti i kontrollit. Nëse të dhënat financiare tremujore dhe gjashtëmujore nuk janë të audituara apo të kontrolluara, atëherë, edhe ky fakt duhet të deklarohet.</p> <p>Nëse prospekti hartohet më shumë se nëntë muaj pas datës së mbylljes së pasqyrave të fundit financiare të audituara, ai duhet të përmbajë informacion të ndërmjetëm financiar, që mund të jetë i paaudituar (që, në këtë rast, duhet deklaruar) për të paktën gjashtë muajt e parë të vitit financiar.</p>
Pika 18.3	<p>Auditimi i të dhënave historike financiare vjetore</p>
Pika 18.3.1	<p>Informacioni financiar vjetor historik duhet t'i nënshtrohet auditimit të pavarur.</p>
Pika 18.3.2	<p>Deklarim i informacioneve të tjera që janë audituar nga audituesit.</p>
Pika 18.3.3	<p>Kur të dhënat financiare nuk janë marrë nga pasqyrat e audituara financiare të emetuesit, të deklarohet burimi i informacionit dhe fakti që informacioni është i paaudituar.</p>
Pika 18.3.4	<p>Përshkrim i çdo ndryshimi të rëndësishëm në gjendjen financiare apo tregtare të grupit, që ka ndodhur deri në fund të periudhës së fundit financiare, për të cilën është publikuar pasqyra financiare e audituar ose</p>

	informacioni i ndërmjetëm financiar. Në të kundërt, duhet paraqitur një pasqyrë me vlerë negative.
Pika 18.4	Politika e dividendëve
Pika 18.4.1	Përshkrim i politikës së emetuesit për shpërndarjen e dividendëve dhe kufizimet e saj. Nëse emetuesi nuk e ka një politikë të tillë, të përfshihet pasqyra përkatëse me vlerë negative.
Pika 18.4.2	Vlera e dividendit për aksion për secilin vit financiar për periudhën që mbulojnë të dhënat financiare historike, të korrigjuara, kur ka pasur ndryshim të numrit të aksioneve të emetuesit, për ta bërë këtë informacion të krahasueshëm.
Pika 18.5	Proceset ligjore dhe të arbitrazhit
Pika 18.5.1	Informacion për çdo procedurë shtetërore, ligjore ose arbitrazhi (përfshi procese që janë ende të papërfunduara apo që pritet të fillojnë, për të cilat emetuesi ka dijeni) gjatë një periudhe që shtrihet të paktën gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit, që mund të ketë ose ka pasur në të shkuarën e afërt pasoja të konsiderueshme mbi gjendjen financiare ose fitimet e emetuesit dhe/ose grupit ose të paraqitet pasqyra përkatëse me vlerë negative.
RUBRIKA 19	INFORMACION SHITESË
Pika 19.1	Kapitali aksionar Informacioni i parashikuar në pikat 18.1.2 deri në 18.1.2 për të dhënat financiare historike deri në datën e bilancit më të fundit:
Pika 19.1.1	Shuma e kapitalit të emetuar dhe për çdo klasë të aksioneve përfshin: (a) numrin total të aksioneve të emetuesit; (b) numrin e aksioneve të emetuara dhe të paguara plotësisht dhe të emetuara, por jo të paguara plotësisht; (c) vlerën nominale për aksion ose aksionet që nuk kanë vlerë nominale dhe (d) një rakordim të numrit të aksioneve të papaguara në fillim dhe në fund të vitit financiar
Pika 19.1.2	Një historik të kapitalit aksionar, që nxjerr në pah informacionet mbi ndryshimet e ndodhura për periudhën që mbulon të dhënat financiare historike.
Pika 19.2	Akti i themelimit dhe statuti

Pika 19.2.1	Regjistrimi në regjistrin tregtar, numri i regjistrimit, nëse ka dhe një përshkrim i shkurtër i objektivave dhe qëllimeve të emetuesit dhe se ku mund të gjenden këto të dhëna në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.
Pika 19.2.2	Kur ka më shumë se një klasë aksionesh, një përshkrim i të drejtave, preferencave dhe kufizimeve që lidhen me secilën prej tyre.
Pika 19.2.3	Një përshkrim i shkurtër i çdo dispozite të aktit themelues, statutit apo akteve të brendshme të emetuesit, që do të kishin për pasojë vonimin, shtyrjen ose pengimin e një ndryshimi në kontrollin e emetuesit.
RUBRIKA 20	KONTRATAT THEMELORE
Pika 20.1	<p>Përmbledhje të secilës kontratë themelore, që nuk është kontratë e lidhur gjatë veprimtarisë së zakonshme tregtare, ku emetuesi ose anëtarët e grupit janë palë gjatë dy viteve të fundit që i paraprijnë publikimit të prospektit.</p> <p>Një përmbledhje e çdo kontrate tjetër (që nuk është kontratë e lidhur gjatë aktivitetit të zakonshëm tregtar), e lidhur nga çdo anëtar i grupit, e cila përmban dispozita sipas të cilave çdo anëtar i grupit ka detyrime ose të drejta, që në datën e prospektit, ka rëndësi thelbësore për grupin.</p>
RUBRIKA 21	DOKUMENTET NË DISPOZICION
Pika 21.1	<p>Një deklaratë se përgjatë afatit të vlefshmërisë së prospektit, dokumentet e mëposhtme mund të kontrollohen, sipas rastit:</p> <p>(a) statuti dhe akti i themelimit i emetuesit në variantin e tyre të fundit;</p> <p>(b) të gjitha raportet, letrat dhe dokumentet, vlerësimet dhe deklaratat e tjera të përgatitura nga ekspertët me kërkesë të emetuesit, pjesë të të cilave janë përfshirë ose përmendur në prospekt;</p> <p>(c) të dhënat financiare historike të emetuesit ose, në rastin e grupit, të dhënat historike financiare për emetuesin dhe shoqëritë e kontrolluara të tij, për secilin prej dy vjetëve financiarë që i paraprijnë datës së publikimit të prospektit. Adresa e faqes së internetit, ku mund të konsultohen dokumentet me anë të mjeteve fizike ose elektronike.</p>

KREU III – SHËNIMI MBI TITULLIN

RUBRIKA 1	PERSONAT PËRGJEGJËS, INFORMACIONI NGA PALËT E TRETA, RAPORTET E EKSPERTËVE DHE MIRATIMI NGA AUTORITETI KOMPETENT
Pika 1.1	Identifikoni të gjithë personat përgjegjës për informacionin ose pjesë të tij, që paraqitet në shënimin e titullit, duke shënuar, për rastin e dytë, cilat janë këto pjesë. Në rastin e personave fizikë, përfshi anëtarë të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit, shënoni emrin dhe funksionin e personit; në rastin e personave juridikë, shënoni emrin dhe adresën e regjistruar.
Pika 1.2	<p>Një deklaratë nga personat përgjegjës për titujt që, në dijeninë e tyre, informacioni që përfshihet në shënimin e titullit është në përputhje me faktet dhe se shënimi i titujve nuk ka lënë jashtë asnjë informacion që mund të ndikojë në kuptimin e tij.</p> <p>Kur është rasti, një deklaratë nga personat përgjegjës për pjesë të caktuara të shënimit të titujve që, në dijeninë e tyre, informacioni që përfshihet në ato pjesë të shënimit të titujve, për të cilin ata janë përgjegjës, është në përputhje me faktet dhe ato pjesë të shënimit të titujve nuk lënë jashtë asnjë informacion që mund të cenojë kuptimin e tyre.</p>
Pika 1.3	<p>Kur një deklaratë a raport që i atribuohet një personi si ekspert përfshihet në dokumentin e regjistrimit, jepni të dhënat e personit për emrin, adresën e biznesit, kualifikimet dhe interesin material të emetuesit, nëse ka.</p> <p>Nëse deklarata ose raporti janë hartuar me kërkesë të emetuesit, shënoni që deklarata ose raporti është përfshirë në shënimin e titujve me miratimin e personit, i cili ka autorizuar përmbajtjen e asaj pjese të shënimit të titujve, për qëllimet e prospektit.</p>
Pika 1.4	Kur informacioni është marrë nga palë të treta, konfirmoni që ky informacion është riprodhuar saktësisht dhe për aq sa emetuesi ka dijeni apo është në gjendje të vërtetojë nga informacioni i publikuar nga kjo palë e tretë, nuk është hequr asnjë fakt që do ta bënte informacionin e riprodhuar të pasaktë ose çorientues. Përveç kësaj, identifikoni burimin/burimet e informacionit.
RUBRIKA 2	FAKTORËT E RREZIKUT
Pika 2.1	<p>[Për titujt e pjesëmarrjes në kapital]:</p> <p>Një përshkrim i rreziqeve themelore që janë specifike për titujt e ofruar dhe të pranuar për t'u treguar në një numër të kufizuar kategorish, në një rubrikë të titulluar, 'Faktorët e rrezikut'.</p> <p>Në secilën kategori, të parat do të renditen rreziqet më të rëndësishme, sipas vlerësimit të emetuesit, duke marrë parasysh ndikimin negativ tek emetuesi</p>

	<p>dhe titujt dhe gjasat që ato të ndodhin. Rreziqet do të mbështeten nga përmbajtja e shënimit të titujve.</p> <p>[Për titujt jo të pjesëmarrjes në kapital]:</p> <p>Përshkrim i rreziqeve themelore që janë specifike për titujt e ofruar dhe të pranuar për t'u treguar në një numër të kufizuar kategorish, në një rubrikë të titulluar, 'Faktorët e rrezikut'.</p> <p>Rreziqet që do të deklarohen përfshijnë ato që vijnë si rezultat i nënrenditjes së titullit dhe ndikimit në masën apo afatin e pritshëm të pagesave ndaj mbajtësit të titujve në rast falimenti ose çdo procedure tjetër të ngjashme, dhe në rastet kur titujt janë të garantuar, rreziqet specifike dhe thelbësore që lidhen me garantin në atë pikë në të cilën ndikojnë në aftësinë e tij për të përmbushur angazhimin e tij në bazë të garancisë. Në secilën kategori, të parat do të përcaktohen rreziqet më thelbësore, sipas vlerësimit të emetuesit, ofertuesit ose personit që kërkon pranim për tregtim në një treg të rregulluar, duke marrë në konsideratë ndikimin negativ mbi emetuesin dhe titujt, si dhe gjasat që ato të ndodhin. Rreziqet mbështeten nga informacioni në përmbajtjen e shënimit të titujve.</p>
RUBRIKA 3	INFORMACION THEMELOR
Pika 3.1	<p>[Për titujt e pjesëmarrjes në kapital]:</p> <p>Deklarata e kapitalit të punës</p> <p>Deklaratë nga emetuesi se, sipas mendimit të tij, kapitali i punës është i mjaftueshëm për kërkesat aktuale të emetuesit ose, nëse nuk është kështu, si propozon të sigurojë kapitalin e nevojshëm shtesë të punës.</p> <p>[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Pika 3.1 nuk kërkohet</p>
Pika 3.2	<p>[Për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Kapitalizimi dhe borxhi</p> <p>Një deklaratë kapitalizimi dhe borxhi të përditësuar dhe jo më të vjetër sesa 90 ditë nga data e dokumentit. Termi 'borxh' përfshin edhe borxhin e tërthortë dhe të kushtëzuar.</p> <p>Në rast ndryshimesh thelbësore në gjendjen e kapitalizimit dhe borxhit të emetuesit brenda një periudhe prej [90] ditësh, jepen të dhëna shtesë përmes paraqitjes së një përshkrimi të këtyre ndryshimeve ose përmes përditësimit të shifrave përkatëse.</p> <p>[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Pika 3.2 nuk kërkohet</p>
Pika 3.3	<p>Interesi i personave fizikë dhe juridikë të përfshirë në emetim/ofertë</p> <p>Përshkrim i të gjitha interesave, përfshi konfliktin e interesit, që ka ndikim në emetim/ofertë, duke dhënë detaje për personat e përfshirë dhe natyrën e interesit.</p>

Pika 3.4	<p>Arsyet e ofertës dhe përdorimi i të ardhurave [Për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Arsyet për ofertën dhe, sipas rastit, për vlerën e përlllogaritur të të ardhurave të zberthyera në bazë të secilit përdorim kryesor të synuar dhe të paraqitura në rend përparësie të këtyre përdorimeve. Nëse emetuesi është i vetëdijshëm se të ardhurat e parashikuara nuk do të jenë të mjaftueshme për të financuar të gjitha përdorimet e propozuara, deklaroni vlerën dhe burimet e fondeve të tjera të nevojshme. Duhet dhënë hollësi edhe lidhur me përdorimin e të ardhurave, veçanërisht kur përdoren për blerjen e aktivëve, që nuk janë pjesë e veprimtarisë së zakonshme tregtare, për të financuar blerjet e deklaruara të bizneseve të tjera ose për të shkarkuar, ulur ose shlyer borxhin.</p> <p>[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Arsyet për ofrimin e titujve publikut dhe pranimin për t'u tregtuar. Kur është e nevojshme, deklarohen shpenzimet e përgjithshme të vlerësuara të emetuesit/ofertës dhe vlera e përlllogaritur neto e të ardhurave. Këto shpenzime dhe të ardhura zberthehen në bazë të secilit përdorim kryesor të synuar dhe të paraqitura në rend përparësie të këtyre përdorimeve. Nëse emetuesi është i vetëdijshëm se të ardhurat e parashikuara nuk do të jenë të mjaftueshme për të financuar të gjitha përdorimet e propozuara, deklaroni vlerën dhe burimet e fondeve të tjera të nevojshme.</p>
RUBRIKA 4	INFORMACION RRETH TITUJVE QË OFROHEN/PRANOHEN PËR TREGTIM
Pika 4.1	Përshkrim i llojit dhe klasës së titujve që do të ofrohen dhe do të pranohen për tregtim, përfshi kodin ndërkombëtar të identifikimit të titujve ('ISIN').
Pika 4.2	Legjislacioni në bazë të të cilit janë krijuar titujt.
Pika 4.3	Të dhëna nëse titujt janë në formë të regjistruar apo si instrumente të mbajtësit dhe nëse titujt janë në formë certifikate apo të regjistruar në regjistrin kontabël. Në rastin e fundit, deklarohet emri dhe adresa e subjektit të ngarkuar për mbajtjen e të dhënave.
Pika 4.3.1	[Vetëm për titujt pa pjesëmarrje në kapital]: Vlera e përgjithshme e titujve që i ofrohen publikut/pranohen për tregtim. Nëse vlera nuk është fikse, të deklarohet vlera maksimale e titujve që do të ofrohen (nëse është e vlefshme) dhe një përshkrim i rregullave dhe afatit për shpalljen në publik të vlerës përfundimtare të ofertës.
Pika 4.4	Monedha e titujve të emetuar.
Pika 4.4.1	[Vetëm për titujt pa pjesëmarrje në kapital]: Prioriteti relativ i titujve në strukturën e kapitalit në rast falimentimi, përfshi, kur është rasti, informacione mbi shkallën e nënrenditjes së titujve.

Pika 4.5

Përshkrim i të drejtave që lidhen me titujt, përfshi kufizimet e këtyre të drejtave dhe procedurën për ushtrimin e këtyre të drejtave:

[Për titujt me pjesëmarrje në kapital]:

të drejtat mbi dividendin:

- (i) data/datat fikse në të cilat lind e drejta;
- (ii) afati pas të cilit pushon e drejta për dividend dhe deklarimi i personit në favor të të cilit shkon e drejta e pushuar;
- (iii) Kufizimet dhe procedurat për shpërndarjen e dividendit për mbajtësit jorezidentë;
- (iv) norma e dividendit ose metoda e përlllogaritjes së tij, shpeshtësia dhe natyra me akumulim ose pa akumulim e pagesave;

të drejtat e votës;

të drejtat e blerjes paraprake për nënshkrimin e titujve të së njëjtës klasë;

e drejta për ndarjen e fitimeve të emetuesit;

e drejta për ndarjen e çdo teprice, në rast likuidimi;

dispozitat e riblerjes;

dispozitat e konvertimit.

[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:

- norma nominale e interesit
- dispozitat që lidhen me interesin e pagueshëm
- data prej së cilës interesi bëhet i pagueshëm
- datat e shlyerjes së interesit
- afati i vlefshmërisë së pretendimeve kundrejt interesit dhe shlyerjes së principalit

Kur norma nuk është fikse:

- deklaratë që përcakton llojin e bazës së përlllogaritjes
- përshkrimi instrumentit bazë mbi të cilin bazohet norma
- metoda e përdorur për të lidhur normën me instrumentin bazë
- të dhëna se ku mund të përftohet përmes mjeteve elektronike informacioni mbi performancën e shkuar dhe të ardhshme të instrumentit bazë dhe paqëndrueshmërinë e tij dhe nëse ky informacion mund të merret ose jo pa pagesë
- përshkrim i çrregullimeve në treg ose në shlyerje që prekin instrumentin bazë
- çdo rregull korrigjues që ka lidhje me ngjarjet që përfshijnë instrumentin bazë
- emri i agjentit që bën llogaritjet

	<ul style="list-style-type: none"> nëse titulli ka komponent derivativ në pagesën e interesit, duhet një shpjegim i qartë dhe gjithëpërfshirës, për të ndihmuar investuesit të kuptojnë sesi ndikohet vlera e investimit të tyre nga vlera e instrumentit/instrumenteve bazë, veçanërisht në rrethanat kur rreziqet janë më të dukshme. <p>Informacion i mëtejshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> Data e maturimit Hollësi rreth marrëveshjeve të amortizimit të huasë, përfshi procedurat e shlyerjes. Kur mendohet amortizimi me paradhënie, me nismën e emetuesit ose të mbajtësit, ai do të përshkruhet duke përcaktuar kushtet dhe kriteret e amortizimit Përshkrimi në formë të përmbledhur i metodës përmes së cilës përlllogaritet kthimi
Pika 4.5.1	<p>[Vetëm për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Paraqitje e mbajtësve të titujve pa pjesëmarrje në kapital, përfshi identifikimin e organizatave që përfaqësojnë investuesit dhe dispozitat që zbatohen për këtë përfaqësim. Informacion rreth faqes së internetit ku publiku mund të ketë qasje pa pagesë në kontratat që lidhen me këto forma përfaqësimi.</p>
Pika 4.6	Në rast emetimesh të reja, një deklaratë për zgjidhjet, autorizimet dhe miratimet përmes të cilave është krijuar ose do të krijohet dhe/ose do të emetohet titulli.
Pika 4.7	Në rastin e emetimeve të reja, data e pritshme e emetimit të titujve.
Pika 4.8	Një përshkrim i kufizimeve të transferueshmërisë së titujve.
Pika 4.9	<p>[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Deklaratë për ekzistencën e legjislacionit kombëtar mbi blerjet që zbatohen për emetuesin, që mund të krijojnë pengesa për blerjen, nëse ka.</p> <p>Një përshkrim i shkurtër i të drejtave dhe detyrimeve të aksionarëve, në rast ofertash të detyrueshme blerjeje dhe/ose rregullat e nxjerrjes jashtë ose rregullat e shitjes në raport me titujt.</p>
Pika 4.10	<p>[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Informacion për ofertat publike të blerjes nga palët e treta në raport me kapitalin e emetuesit, që janë bërë gjatë vitit të fundit financiar dhe gjatë atij aktual. Duhet deklaruar çmimi ose kushtet e shkëmbimit bashkëlidhur me ofertën dhe rezultati përkatës.</p>
Pika 4.11	Një paralajmërim që legjislacioni tatimor i shtetit të investuesit dhe vendit të themelimit të emetuesit mund të ndikojnë në të ardhurat e përfuara nga titujt. Informacion mbi trajtimin tatimor të titujve, kur investimi i propozuar

	përballet me një regjim tatimor të posaçëm për këtë lloj investimi.
RUBRIKA 5	KUSHTET DHE KRITERET PËR OFRIMIN E TITUJVE PUBLIKUT
Pika 5.1	Kushtet, statistikat e ofertës, kalendari i pritshëm dhe veprimet e nevojshme për të aplikuar për ofertën.
Pika 5.1.1	Kushtet të cilave u nënshtrohet oferta.
Pika 5.1.2	[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]: Vlera e përgjithshme e emetimit/ofertës, ku dallohen titujt e ofruar për shitje dhe ata të ofruar për nënshkrim; nëse vlera nuk është fikse, të dhëna mbi vlerën maksimale të titujve që do të ofrohen (nëse ka) dhe një përshkrim të rregullave dhe afatit për shpalljen publikut të vlerës përfundimtare të ofertës. Në rast se në prospekt nuk mund të jepet vlera maksimale, prospekti përcakton se pranimet e blerjes ose nënshkrimit të titujve mund të tërhiqen për jo më pak se dy ditë pune pasi është paraqitur sasia e titujve që do t'i ofrohen publikut.
Pika 5.1.3	Periudha kohore, përfshi çdo ndryshim të mundshëm, gjatë së cilës do të hapet oferta përshkrim i procesit të aplikimit.
Pika 5.1.4	[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]: Një shënim se kur dhe në cilat rrethana mund të tërhiqet ose pezullohet oferta dhe nëse tërheqja mund të bëhet pas nisjes së tregtimit.
Pika 5.1.5	Një përshkrim të mundësive për uljen e nënshkrimeve dhe mënyrën për të rimbursuar shumat e paguara tepër nga kërkuesit.
Pika 5.1.6	Hollësi mbi vlerën minimale dhe/ose maksimale të kërkesës (qoftë në numër titujsh apo vlerë të përgjithshme që do të investohet).
Pika 5.1.7	Informacion rreth periudhës në të cilët kërkesa mund të tërhiqet, me kusht që investuesit të lejohen të tërheqin nënshkrimin e tyre.
Pika 5.1.8	Metodën dhe afatin e pagesës së titujve dhe dorëzimit të titujve.
Pika 5.1.9	Përshkrim i plotë i mënyrës dhe datës kur do të bëhen publike rezultatet e ofertës.
Pika 5.1.10	Procedura për ushtrimin e të drejtave të parablerjes, negociueshmërisë së nënshkrimit dhe trajtimit të drejtave të paushtruara të nënshkrimit.
Pika 5.2	Plani i shpërndarjes dhe caktimit.

Pika 5.3	Çmimi i vendosur
Pika 5.3.1	<p>[Për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Informacion për çmimin me të cilin ofrohen titujt dhe vlera e shpenzimeve dhe tatimeve që i ngarkohen nënshkruesit ose blerësit.</p> <p>Nëse çmimi nuk dihet, atëherë, deklaroni:</p> <p>(a) çmimin maksimal, nëse është i disponueshëm;</p> <p>(b) metodën dhe kriteret dhe/ose kushtet e vlerësimit, në përputhje me të cilat është përcaktuar ose do të përcaktohet oferta e çmimit përfundimtar dhe një shpjegim i metodave të vlerësimit që janë përdorur.</p> <p>Kur as pika (a), as (b) nuk mund të paraqiten në shënimin e titullit, shënimi i titullit do të përfshijë specifikisht se pranimet e blerjes ose nënshkrimit të titujve mund të tërhiqen jo më vonë se deri në dy ditë pune pasi është paraqitur çmimi i ofertës përfundimtare i titujve që do t'i ofrohen publikut.</p> <p>[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Deklarim i çmimit të pritshëm me të cilin do të ofrohen titujt. Kur nuk është e mundur të jepet çmimi i pritshëm, në përshkrim i metodës së përcaktimit të çmimit. Dhënie e vlerës së shpenzimeve dhe taksave që i ngarkohen nënshkruesit ose blerësit.</p>
Pika 5.3.2	<p>[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Procesi i deklarimit të çmimit të ofertës.</p>
Pika 5.3.3	<p>[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Nëse mbajtësi i kapitalit i emetuesit ka të drejta parablerjeje dhe kjo e drejtë kufizohet ose tërhiqet, përshkrim i bazës për çmimin e emetimit, nëse emetimi bëhet kundrejt parasë, së bashku me arsyet dhe përfituesit e këtij kufizimi ose tërheqjeje.</p>
Pika 5.3.4	<p>[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Kur ka ose mund të ketë pabarazi thelbësore midis çmimit të ofertës publike dhe kostos efektive në para për anëtarët e organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse ose bashkëpunëtorët e titujve të blerë prej tyre në transaksione gjatë vitit të fundit ose të cilat ata kanë të drejtë të blejnë, përfshini një krahasim të kontributit në ofertën e propozuar publike dhe kontributet e dhëna në para të këtyre personave.</p>
Pika 5.4	Hedhja në treg dhe nënshkrimi
Pika 5.4.1	Emri dhe adresa e koordinatorit/koordinatorëve të ofertës globale dhe pjesëve të veçanta të ofertës dhe, për aq sa ka dijeni në emetim, personave që e hedhin në treg në vende të ndryshme ku bëhet oferta.

Pika 5.4.2	Emri dhe adresa e agjentëve pagues agjentëve depozitarë.
Pika 5.4.3	Emri dhe adresa e subjekteve që bien dakord të nënshkruajnë emetimin mbi baza angazhimi të përcaktuar dhe emri e adresa e subjekteve që bien dakord të hedhin në treg emetimin pa angazhim të përcaktuar ose sipas rregullave të 'përpjekjeve' më të mira. Informacion mbi tiparet themelore të marrëveshjeve, përfshi kuotat. Kur jo i gjithë emetimi është nënshkruar, një deklaratë mbi pjesën që nuk mbulohet. Informacion mbi shumën e përgjithshme të komisionit të nënshkrimit dhe komisionit të hedhjes në treg.
Pika 5.4.4	Kur është lidhur ose do të lidhet marrëveshja e nënshkrimit.
RUBRIKA 6	PRANIMI PËR TREGTIM DHE RREGULLAT E TREGTIMIT
Pika 6.1	Kërkesa për pranim për t'u tregtuar, me qëllim shpërndarjen në një treg të rregulluar
Pika 6.2	Tregjet e rregulluara në të cilat, me sa ka dijeni emetuesi, titujt e së njëjtës klasë titujsh që do të ofrohen apo pranohen për tregtim, janë pranuar tashmë për t'u tregtuar.
Pika 6.3	<p>[Për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Nëse njëkohësisht ose thajse njëkohësisht me kërkesën për pranimin e titujve në një treg të rregulluar, titujt e së njëjtës klasë nënshkruhen ose hidhen privatisht në treg ose nëse krijohen titujt të klasave të tjera për publikun apo hedhjen privatisht në treg, jepni hollësi lidhur me natyrën e këtyre ndërhyrjeve dhe me numrin, karakteristikat dhe çmimin e titujve me të cilët kanë lidhje.</p> <p>[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Emri dhe adresa e subjekteve që kanë angazhim të përcaktuar për të vepruar si ndërmjetës në tregun dytësor, duke ofruar likuiditet përmes normave të blerjeve dhe ofertës dhe përshkrim i kriterëve kryesore për angazhimin e tyre.</p>
Pika 6.4	<p>[Për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Për pranimin për tregtim në një treg të rregulluar, hollësi rreth subjekteve që kanë ofruar angazhim të përcaktuar për të vepruar si ndërmjetës në treg dytësor, duke ofruar likuiditet përmes normave të blerjeve dhe ofertës dhe përshkrim i kriterëve kryesore për angazhimin e tyre.</p> <p>[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Çmimi i emetimit të titujve</p>

RUBRIKA 7	MBAJTËSIT QË SHESIN TITUJT [Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]
Pika 7.1	Emri dhe adresa e aktivitetit tregtar të subjektit që ofron të shesë titujt, natyra epozicioneve ose marrëdhënieve të tjera thelbësore që shitësi ka mbajtur gjatë tre vjetëve të fundit me emetuesin ose me ndonjë prej paraardhësve apobashkëpunëtorëve.
Pika 7.2	Numri dhe klasa e titujve të ofruar nga secili prej mbajtësve që shesin titujt.
Pika 7.3	Kur një aksionar i shumicës shet titujt, pjesën e aksioneve që zotëron si përpara, ashtu edhe menjëherë pas emetimit.
RUBRIKA 8	SHPENZIMET E EMETIMIT/OFERTËS
Pika 8.1	Të ardhurat e përgjithshme neto dhe një vlerësim i shpenzimeve të përgjithshme të emetimit/ofertës.
RUBRIKA 9	INFORMACION SHITESË
Pika 9.1	Nëse këshilltarët që kanë lidhje me një emetim përmenden në Shënimin e Titullit, deklarata e cilësisë në të cilën kanë vepruar këshilltarët.
Pika 9.2	Përfshirje e informacioneve të tjera në shënimin e titullit që është audituar ose kontrolluar nga audituesit ligjorë dhe kur audituesit kanë hartuar një raport, riprodhim të raportit ose, me lejen e autoritetit kompetent, përmbledhje të raportit.
Pika 9.3	[Vetëm për titujt pa pjesëmarrje në kapital]: Klasifikimi i rrezikut të kreditit që lidhet me titujt, me kërkesë ose në bashkëpunim me emetuesin gjatë procesit të vlerësimit. Një shpjegim i shkurtër se çfarë nënkuptojnë klasifikimet, nëse kjo është publikuar më parë nga ofruesi i klasifikimit

SHTOJCA II – FORMATI STANDARD I DOKUMENTIT TË REGJISTRIMIT

RUBRIKA 1	PERSONAT PËRGJEGJËS, INFORMACIONI NGA PALËT E TRETA, RAPORTET E EKSPERTËVE DHE MIRATIMI NGA AUTORITETI KOMPETENT
Pika 1.1	Identifikoni të gjithë personat përgjegjës për informacionin ose pjesë të tij, që paraqitet në dokumentin e regjistrimit, duke shënuar, për rastin e dytë, cilat janë këto pjesë. Në rastin e personave fizikë, përfshi anëtarë të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit, shënoni emrin dhe funksionin e personit; në rastin e personave juridikë, shënoni emrin dhe adresën e regjistruar.
Pika 1.2	Një deklaratë nga personat përgjegjës për dokumentin e regjistrimit që, në dijeninë e tyre, informacioni që përfshihet në dokumentin e regjistrimit është në përputhje me faktet dhe se dokumenti i regjistrimit nuk ka lënë jashtë asnjë informacion që mund të ndikojë në kuptimin e tij. Kur është rasti, një deklaratë nga personat përgjegjës për pjesë të caktuara të dokumentit të regjistrimit që, në dijeninë e tyre, informacioni që përfshihet në ato pjesë të dokumentit të regjistrimit, për të cilin ata janë përgjegjës, është në përputhje me faktet dhe ato pjesë të dokumentit të regjistrimit nuk lënë jashtë asnjë informacion që mund të cenojë kuptimin e tyre.
Pika 1.3	Kur një deklaratë a raport që i atribuohet një personi si ekspert përfshihet në dokumentin e regjistrimit, jepni të dhënat e personit për emrin, adresën e biznesit, kualifikimet dhe interesin material të emetuesit, nëse ka. Nëse deklarata ose raporti janë hartuar me kërkesë të emetuesit, shënoni që deklarata ose raporti është përfshirë në dokumentin e regjistrimit me miratimin e personit, i cili ka autorizuar përmbajtjen e asaj pjese të dokumentit të regjistrimit, për qëllimet e prospektit.
Pika 1.4	Kur informacioni është marrë nga palë të treta, konfirmoni që ky informacion është riprodhuar saktësisht dhe për aq sa emetuesi ka dijeni apo është në gjendje të vërtetojë nga informacioni i publikuar nga kjo palë e tretë, nuk është hequr asnjë fakt që do ta bënte informacionin e riprodhuar të pasaktë ose çorientues. Përveç kësaj, identifikoni burimin/burimet e informacionit.
RUBRIKA 2	AUDITUESIT LIGJORË
Pika 2.1	Emrat dhe adresat e audituesve të emetuesit për periudhën që mbulon informacioni historik financiar (së bashku me anëtarësinë e tyre në një urdhër profesional).
Pika 2.2	Jepni hollësi, nëse janë me rëndësi, nëse audituesit kanë dhënë dorëheqjen,

	janë shkarkuar ose nuk janë riemëruar gjatë periudhës që mbulon informacioni historik financiar.
RUBRIKA 3	FAKTORËT E RREZIKUT
Pika 3.1	Një përshkrim i rreziqeve materiale që janë specifike për emetuesin në një numër të kufizuar kategorish, në një rubrikë të titulluar, ‘Faktorët e rrezikut’. Në secilën kategori, të parat do të renditen rreziqet më të rëndësishme, sipas vlerësimit të kryer nga emetuesi emetuesit, duke marrë parasysh ndikimin negativ tek emetuesi dhe gjasat që ato të ndodhin. Rreziqet do të mbështeten nga përmbajtja e dokumentit të regjistrimit.
RUBRIKA 4	INFORMACION RRETH EMETUESIT
Pika 4.1	Emri juridik dhe tregtar i emetuesit.
Pika 4.2	Vendi i regjistrimit të emetuesit, numri i tij i regjistrimit dhe numri i identifikimit si subjekt juridik (NIPT-i).
Pika 4.3	Data e themelimit dhe kohëzgjatja e emetuesit, me përjashtim kur është periudhë e pacaktuar.
Pika 4.4	Selia qendrore dhe personaliteti juridik, legjislacioni në bazë të të cilit vepron emetuesi, vendi i themelimit, adresa, numri i telefonit të adresës së regjistruar (ose vendit kryesor të aktivitetit, nëse ndryshon nga selia e regjistruar) dhe faqja e internetit të emetuesit, nëse ka, me një paralajmërim se informacioni në faqen në internet nuk është pjesë e prospektit.
RUBRIKA 5	PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I AKTIVITETIT
Pika 5.1	Veprimtaritë kryesore
Pika 5.1.1	Përshkrimi i faktorëve kryesorë për natyrën e operacioneve të emetuesit dhe veprimtaritë e tij kryesore, duke përcaktuar kategoritë kryesore të produkteve të shitura dhe/ose shërbimeve të kryera për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike të pasqyrave financiare;
Pika 5.1.2	Një përshkrim i çdo produkti dhe/ose shërbimi të ri të rëndësishëm të futur rishtazi dhe, me kusht që zhvillimi i këtyre produkteve apo shërbimeve të reja të jetë bërë publik, të tregohet statusi i zhvillimit të tyre.
Pika 5.2	Tregjet kryesore Një përshkrim i tregjeve kryesore, në të cilat konkurren emetuesi, përfshirë një pasqyrë të të ardhurave të përgjithshme sipas segmentit të tregut të

	produktit dhe atij gjeografik për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike të pasqyrave financiare.
Pika 5.3	Ngjarjet e rëndësishme në zhvillimin e aktivitetit të emetuesit.
Pika 5.4	Strategjia dhe objektivat Një përshkrim i strategjisë dhe objektivave tregtare, financiare e jofinanciare (nëse ka) të emetuesit. Ky përshkrim merr parasysh sfidat dhe perspektivat e ardhshme të emetuesit.
Pika 5.5	Nëse janë të një rëndësie thelbësore për veprimtarinë tregtare ose të ardhurat e emetuesit, informacione përmbledhëse për nivelin e varësisë së emetuesit nga patenta ose licenca, kontrata industriale, tregtare ose financiare, ose procese të reja prodhimi.
Pika 5.6	Burimin e çdo deklaratë të bërë nga emetuesi për pozicionin e tij konkurrues në treg.
Pika 5.7	Investimet
Pika 5.7.1	Një përshkrim (përfshirë shumën) të investimeve kryesore të emetuesit për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike financiare deri në datën e dokumentit të regjistrimit.
Pika 5.7.2	Një përshkrim të investimeve kryesore të emetuesit, të cilat janë në proces ose për të cilat janë marrë përsipër angazhime, përfshirë shpërndarjen gjeografike të këtyre investimeve (brenda dhe jashtë vendit) dhe mënyrën e financimit (të brendshëm ose të jashtëm).
Pika 5.7.3	Informacion në lidhje me sipërmarrjet e përbashkëta, ku emetuesi është pjesëmarrës dhe shoqëritë në të cilat emetuesi zotëron një pjesëmarrje të tillë në kapital, që mund të ketë një efekt të konsiderueshëm në vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve të veta, pozicionit financiar ose fitimit dhe humbjes.
Pika 5.7.4	Një përshkrim i çdo problemi mjedisor, që mund të ndikojë në përdorimin që u bën emetuesi aktiveve afatgjata materiale.
RUBRIKA 6	STRUKTURA ORGANIZATIVE
Pika 6.1	Nëse emetuesi është pjesë e një grupi, në strukturën organizative duhet të jepet një përshkrim i shkurtër i grupit dhe i pozicionit të emetuesit brenda grupit. Kjo mund të jetë në formën e një diagrami të strukturës organizative ose mund të shoqërohet me një diagram të tillë, nëse kjo ndihmon në sqarimin e strukturës.

Pika 6.2	Një listë e shoqërive të kontrolluara më të rëndësishme, përfshirë emrin, vendin e themelimit ose vendin e selisë, pjesën e interesit të pronësisë dhe, nëse është e ndryshme, të drejtat e votës që zotëron.
RUBRIKA 7	VLERËSIMI OPERATIV DHE FINANCIAR
Pika 7.1	Pozicioni financiar
Pika 7.1.1	<p>Për aq sa nuk mbulohet diku tjetër në dokumentin e regjistrimit dhe deri në atë shkallë që është e nevojshme për të kuptuar aktivitetin tregtar të emetuesit në tërësi, të jepet një vlerësimi drejtë i zhvillimit dhe rezultateve të aktivitetit tregtar të emetuesit dhe gjendjes së tij financiare për çdo vit dhe për periudhat e ndërmjetme, për të cilat kërkohen të dhëna historike financiare, përfshi shkaqet e ndryshimeve kryesore.</p> <p>Ky vlerësim është një analizë e drejtpeshuar dhe gjithëpërfshirëse e zhvillimit dhe rezultateve të aktivitetit tregtar dhe gjendjes financiare të emetuesit, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e aktivitetit të tij.</p> <p>Për aq sa është e nevojshme për të kuptuar zhvillimin, rezultatet ose gjendjen financiare të emetuesit, analiza përmban Treguesit Kryesorë të Performancës financiare dhe, kur duhet, edhe Jofinanciare që janë të rëndësishme për veprimtarinë tregtare përkatëse. Kur është nevojë, analiza përfshin referenca dhe shpjegime shtesë lidhur me vlerat e raportuara në pasqyrat financiare vjetore.</p>
Pika 7.1.2	Për sa nuk trajtohet diku tjetër në dokumentin e regjistrimit dhe për aq sa është e nevojshme për të kuptuar veprimtarinë tregtare të emetuesit në tërësi, vlerësimi përmban po ashtu të dhëna rreth zhvillimeve dhe aktiviteteve të mundshme të emetuesit në të ardhmen në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit.
Pika 7.2	Rezultatet e aktivitetit
Pika 7.2.1	Informacion për faktorët e rëndësishëm, përfshirë ngjarje të pazakonta, të rralla ose zhvillime të reja, që ndikojnë në mënyrë thelbësore tek të ardhurat e emetuesit nga aktiviteti tregtar, duke përcaktuar masën me të cilën preken të ardhurat.
Pika 7.2.2	Kur të dhënat financiare historike paraqesin ndryshime thelbësore në të ardhurat ose shitjet neto, bëni një argumentim përshkrues të arsyeve për këto ndryshime.
RUBRIKA 8	BURIMET E KAPITALIT
Pika 8.1	Informacion për burimet e kapitalit të emetuesit (afatshkurtra dhe afatgjata).

Pika 8.2	Një shpjegim të burimeve dhe vlerave dhe një përshkrim të flukseve monetare të emetuesit.
Pika 8.3	Informacion për kërkesat për huamarrjen dhe strukturën e financimit të emetuesit.
Pika 8.4	Informacion për çdo kufizim për përdorimin e burimeve të kapitalit, që kanë ndikuar në mënyrë thelbësore ose mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në veprimtaritë tregtare të emetuesit.
Pika 8.5	Informacion për burimet e parashikuara të financimit, që janë të nevojshme për përmbushjen e angazhimeve të përcaktuara në pikën 5.7.2.
RUBRIKA 9	MJEDISI RREGULLATOR
Pika 9.1	Një përshkrim i mjedisit rregullator në të cilin ushtron veprimtari emetuesi dhe që mund të ketë ndikim të rëndësishëm në veprimtarinë e tij, së bashku me informacionin për çdo politikë qeveritare, ekonomike, fiskale, monetare ose politike ose faktorë, që kanë ndikuar në mënyrë thelbësore ose mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në aktivitetin tregtar të emetuesit.
RUBRIKA 10	INFORMACION PËR PRIRJET
Pika 10.1	Një përshkrim të prirjeve më të rëndësishme të kohëve të fundit sa i takon prodhimit, shitjes e inventarit, kostove dhe çmimeve të shitjes që nga mbyllja e vitit të fundit financiar deri më sot dhe i çdo ndryshimi të konsiderueshëm në ecurinë financiare të grupit, që nga mbyllja e periudhës së fundit financiare, për të cilën është publikuar informacioni financiar, deri në datën e dokumentit të regjistrimit ose paraqitje e një pasqyre financiare me vlera minus.
Pika 10.2	Informacion për çdo prirje, pasiguri, kërkesë, angazhim ose ngjarje të ditur, të cilat ka mundësi të arsyeshme të kenë një ndikim thelbësor në perspektivat e emetuesit të paktën për vitin financiar aktual.
RUBRIKA 11	PARASHIKIMET OSE VLERËSIMET E FITIMEVE
Pika 11.1	Kur emetuesi ka publikuar një parashikim të fitimit ose një vlerësim të fitimit (që është ende i porealizuar dhe i vlefshëm), ky parashikim ose vlerësim duhet të përfshihet në dokumentin e regjistrimit. Nëse është publikuar një parashikim fitimi ose një vlerësim fitimi i porealizuar, por që nuk është më i vlefshëm, atëherë, jepni informacionin përkatës dhe shpjegoni përse parashikimi ose vlerësimi nuk është më i vlefshëm. Ky parashikim ose vlerësim i pavlefshëm nuk u nënshtrohet kërkesave të pikës

	11.2 dhe 11.3.
Pika 11.2	Kur emetuesi vendos të përfshijë një parashikim të ri të fitimit ose një vlerësim të ri të fitimit, ose një parashikim të publikuar më parë, ose një vlerësim fitimi të publikuar më parë, në bazë të pikës 11.1, parashikimi ose vlerësimi i fitimit duhet të jetë i qartë, të mos lërë vend për keqkuptime dhe të shoqërohet nga një deklaratë, e cila përcakton supozimet kryesore mbi të cilat emetuesi ka mbështetur parashikimin ose vlerësimin.
Pika 11.3	Prospekti përfshin një deklaratë se parashikimi ose vlerësimi i fitimit është përpiluar mbi një bazë që është e krahasueshme me të dhënat historike financiare dhe në përputhje me politikat kontabël të emetuesit.
RUBRIKA 12	ORGANET ADMINISTRATIVE, DREJTUESE DHE MBIKËQYRËSE DHE DREJTUESIT E LARTË
Pika 12.1	<p>Emrat, adresat dhe funksionet që mbajnë pranë emetuesit, si edhe informacion për veprimtaritë kryesore të kryera jashtë emetuesit, kur këto janë të rëndësishme për emetuesin, për personat e mëposhtëm:</p> <p>(a) anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse;</p> <p>(b) ortakë me përgjegjësi të pakufizuar, në rast ortakërie me përgjegjësi të kufizuar me kapital aksionar;</p> <p>(c) themeluesit, nëse emetuesi është themeluar prej më pak se pesë vjetësh;</p> <p>(d) drejtuesit e lartë që janë të aftë të përcaktojnë se emetuesi ka përvojën dhe ekspertizën e duhur për menaxhimin e aktivitetit tregtar të emetuesit.</p> <p>Hollësi mbi natyrën e marrëdhënieve familjare midis çdonjërit prej personave të përmendur në pikat (a) deri në (d).</p> <p>Për çdo anëtar të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit dhe për personat e përmendur në pikat (b) dhe (d) të kësaj pike do të jepen të dhëna për ekspertizën dhe përvojën përkatëse drejtuese, si dhe informacioni në vijim:</p> <p>(a) emrat e të gjitha shoqërive tregtare dhe ortakërive ku këta persona kanë shërbyer si anëtarë të organeve administrative, drejtuese apo mbikëqyrëse ose si ortakë gjatë pesë viteve të mëparshme, përfshi faktin nëse individi vazhdon ose jo të jetë anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse apo ortak. Nuk është e nevojshme të renditen të gjitha shoqëritë e kontrolluara të emetuesit ku personi është gjithashtu anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse;</p> <p>(b) të dhëna nëse është dënuar për vepra mashtrimi të paktën brenda pesë viteve të fundit;</p> <p>(c) të dhëna lidhur me falimente, administrim ligjor, likuidime apo shoqëri të vendosura nën administrim në raport me personat e përkrahur në shkronjat (a) dhe (d) të pikës së parë, të cilët kanë vepruar në një ose më shumë prej këtyre funksioneve të paktën brenda pesë viteve të fundit;</p>

	<p>(d)të dhëna për akuza zyrtare për kryerjen e veprës penale dhe/ose sanksione të vendosura kundër këtyre personave nga autoritetet ligjore ose rregullatore (përfshi urdhrat e përcaktuar profesionalë dhe nëse janë refuzuar me vendim gjykate të veprojnë si anëtarë të organeve administrative, drejtuese apo mbikëqyrëse të një emetuesi apo që të kryejnë funksione në menaxhimin apo drejtimin e veprimtarive të një emetuesi për të paktën pesë vitet e fundit.</p> <p>Nëse nuk ka informacion të tillë nga këto që kërkohen, duhet bërë një deklaratë për këtë qëllim.</p>
Pika 12.2	<p>Konfliktet e interesit të organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse dhe drejtuesve të lartë</p> <p>Konfliktet e mundshme të interesit midis detyrave ndaj emetuesit të personave të përmendur në pikën 12.1 dhe interesave të tyre personale dhe/ose detyrave të tjera duhet të përcaktohen qartë. Nëse nuk ka të tilla konflikte, duhet bërë një deklaratë për këtë qëllim.</p> <p>Çdo marrëveshje ose mirëkuptim me aksionarët kryesorë, investuesit, furnitorët apo të tjerë, sipas të cilëve personat e përmendur në pikën 12.1 janë zgjedhur si anëtarë të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse apo si drejtues të lartë.</p> <p>Të dhëna rreth kufizimeve për të cilat është rënë dakord me personat e përmendur në pikën 12.1 mbi heqjen dorë brenda një afati të caktuar nga kontrolli i titujve të emetuesit.</p>
RUBRIKA 13	SHPËRBLIMI DHE PËRFITIMET
	Në lidhje me vitin e mbyllur financiar, për personat që përmenden në pikat (a) dhe (d) paragrafit të parë të pikës 12.1
Pika 13.1	<p>Vlerat e shpërblimit të paguar (përfshi çdo kompensim të kushtëzuar ose të shtyrë) dhe përfitimet në natyrë, që u jepen personave të tillë nga emetuesi dhe shoqëritë e tij të kontrolluara për shërbimet që secili prej këtyre personave u ofron në të gjitha funksionet emetuesit dhe shoqërive e tij të kontrolluara.</p> <p>Ky informacion duhet të jepet në mënyrë individuale, përveç rastit kur dhënia e informacionit në mënyrë individuale nuk kërkohet në vendin e origjinës së emetuesit dhe nuk është bërë publike në asnjë mënyrë tjetër nga emetuesi.</p>
Pika 13.2	Vlerat e përgjithshme të vëna rezervë ose të akumuluar nga emetuesi ose shoqëritë e tij të kontrolluara për pensione pleqërie ose për përfitime të ngjashme.
RUBRIKA 14	PRAKTIKAT E KËSHILLAVE

	Në lidhje me vitin e mbyllur financiar të emetuesit, nëse nuk është specifikuar ndryshe, për personat që përmenden në pikat (a) dhe (d) paragrafit të parë të pikës 12.1
Pika 14.1	Data e përfundimit të mandatit aktual, nëse ka, dhe periudha gjatë së cilës personi ka shërbyer në këtë funksion.
Pika 14.2	Informacion rreth kontratave të shërbimit të lidhura midis anëtarëve të këshillave administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse dhe emetuesit ose ndonjë prej shoqërive të kontrolluara nga emetuesi, ku parashikohen përfitime nga zgjidhja e marrëdhënieve të punës ose deklarata përkatëse për këtë qëllim që nuk ka të tilla përfitime.
Pika 14.3	Informacion rreth komitetit të auditimit dhe komitetit të pagave të emetuesit, përfshi emrat e anëtarëve të komitetit dhe një përmbledhje e rregullave në bazë të të cilave vepron komiteti.
Pika 14.4	Një deklaratë nëse emetuesi është ose jo në përputhshmëri me regjimin e drejtimit të brendshëm të shoqërisë/shoqërive tregtare, që është i zbatueshëm për emetuesin. Në rast se emetuesi nuk është në përputhje me një regjim të tillë, duhet bërë një deklaratë për këtë qëllim, shoqëruar me një shpjegim të arsyeve pse emetuesi nuk vepron në përputhje me këtë regjim.
Pika 14.5	Efektet e mundshme thelbësore në drejtimin e shoqërisë tregtare, përfshi ndryshimet e ardhshme në përbërjen e këshillit dhe të komitetit (nëse për këtë është marrë tashmë vendim nga këshilli dhe/ose nga asambleja e aksionarëve).
RUBRIKA 15	PUNËMARRËSIT
Pika 15.1	Informacion për numrin e punëmarrësve në fund të periudhës ose mesatarja për secilin vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat financiare historike deri në datën e dokumentit të regjistrimit (dhe ndryshimet e këtij numri, nëse është domethënës) dhe, nëse e mundur dhe me rëndësi, një informacion të detajuar për numrin e personave të punësuar sipas kategorive kryesore të veprimtarisë dhe vendndodhjes gjeografike. Nëse emetuesi punëson një numër të konsiderueshëm punonjësish të përkohshëm, përfshi informacion mbi numrin e punonjësve të përkohshëm gjatë vitit të fundit financiar.
Pika 15.2	Pjesëmarrjet në kapital dhe mundësitë për aksione Për çdo person të përmendur në pikat (a) dhe (d) të paragrafit të parë të pikës 12.1 të jepet informacioni për aksionet që zotërojnë apo mundësi për të tilla aksione të emetuesit në datën më të fundit të mundshme.

Pika 15.3	Përshkrim i marrëveshjeve për përfshirjen e punonjësve në kapitalin e emetuesit.
RUBRIKA 16	AKSIONARËT ME PJESËMARRJE TË LARTË
Pika 16.1	Për sa ka dijeni emetuesi, duhet të jepet emri i çdo personi, që nuk është anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse, i cili, drejtpërdrejt ose tërthorazi, zotëron interes në kapitalin ose të drejtat e votës së emetuesit, që duhet njoftuar në bazë të ligjit, së bashku me informacionin për vlerën e interesit të secilit prej këtyre personave në datën e dokumentit të regjistrimit ose, nëse nuk ka persona të tillë, të lëshohet një deklaratë për këtë qëllim që nuk ka asnjë person të tillë.
Pika 16.2	Nëse aksionarët me pjesëmarrje të lartë në kapitalin e emetuesit kanë ose jo të drejta të ndryshme vote ose një deklaratë për këtë qëllim që nuk ka të tilla të drejta vote.
Pika 16.3	Për sa ka dijeni emetuesi, të deklarohet nëse emetuesi është drejtpërdrejt ose tërthorazi nën pronësinë ose kontrollin e të tjerëve dhe të kujt, si dhe të përshkruhet natyra e kontrollit dhe masat që janë marrë për të siguruar që nuk do të ketë abuzime me këtë kontroll.
Pika 16.4	Përshkrim i marrëveshjeve, për sa ka dijeni emetuesi, zbatimi i të cilave mund të sjellë më pas ndryshim të kontrollit të emetuesit.
RUBRIKA 17	TRANSAKSIONET E PALËT E LIDHURA
Pika 17.1	Duhet paraqitur, në përputhje me standardin përkatës, të dhëna për transaksione të kryera nga emetuesi me palë të lidhura gjatë periudhës së mbuluar nga të dhënat e pasqyrave financiare historike deri në datën e dokumentit të regjistrimit. Nëse këto standarde nuk zbatohen për emetuesin, duhet paraqitur informacioni në vijim: (a)natyra dhe efektet e çdo transaksioni që është, më vete ose në tërësinë e tij, me rëndësi për emetuesin. Kur transaksionet me palët e lidhura nuk janë kryer sipas kushteve të zakonshme të tregut, të jepet një shpjegim përse këto transaksione nuk janë kryer me kushte të zakonshme të tregut. Në rastin e kredive të pashlyera, përfshi garancitë e çdo lloji, të bëhet e ditur shuma e detyrimit të mbetur; (b)shuma ose përqindja që përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura në raport me xhiron e emetuesit.
RUBRIKA 18	TË DHËNAT FINANCIARE MBI AKTIVET, PASIVET, GJENDJEN FINANCIARE DHE FITIMET E HUMBJET E EMETUESIT

Pika 18.1	Të dhënat historike financiare
Pika 18.1.1	Informacion financiar historik i audituar që mbulon 3 vitet e fundit financiare, (ose një periudhë më të shkurtër gjatë së cilës emetuesi ushtron veprimtari) dhe raporti i auditimit për secilin vit, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), nëse është rasti.
Pika 18.1.2	Ndryshimin e datës së periudhës kontabël të raportimit. Nëse emetuesi e ka ndryshuar datën e periudhës kontabël të raportimit gjatë periudhës për të cilën kërkohen të dhënat historike financiare, informacioni historik i audituar mbulon të paktën [36] muaj ose të gjithë periudhën gjatë së cilës emetuesi ka ushtruar veprimtarinë, cilado qoftë më e shkurtër.
Pika 18.1.3	Të dhënat financiare të audituara duhet të përfshijnë të paktën bilancin, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e fluksit të parasë dhe politikat kontabël e shënimet shpjeguese.
Pika 18.1.4	Vjetërsia e informacionit financiar Bilanci i vitit të fundit të të dhënave financiare të audituara nuk mund të jetë më i vjetër sesa si vijon: (a) 18 muaj nga data e regjistrimit të dokumentit, nëse emetuesi përfshin pasqyra të ndërmjetme të audituara në dokumentin e regjistrimit; (b) 16 muaj nga data e regjistrimit të dokumentit, nëse emetuesi përfshin në dokumentin e regjistrimit pasqyra të ndërmjetme financiare të paaudituar.
Pika 18.2	Të dhënat e përkohshme financiare dhe të tjera
Pika 18.2.1	Nëse emetuesi ka publikuar informacion financiar mbi baza tremujore ose gjashtëmujore, që nga data e pasqyrave financiare të fundit të audituara, ato duhet të përfshihen në dokumentin e regjistrimit. Nëse informacioni financiar tremujor ose gjashtëmujor është audituar ose është kontrolluar, duhet të përfshihet edhe raporti i auditimit ose raporti i kontrollit. Nëse nuk janë të audituara apo të kontrolluara, atëherë deklarohet edhe ky fakt. Nëse dokumenti i regjistrimit hartohet më shumë se nëntë muaj pas datës së mbylljes së pasqyrave të fundit financiare të audituara, ai duhet të përmbajë informacion të ndërmjetëm financiar, që mund të jetë ipaaudituar (ky fakt duhet deklaruar) për të paktën gjashtë muajt e parë të vitit financiar.
Pika 18.3	Auditimi i të dhënave historike financiare vjetore.
Pika 18.3.1	Informacioni financiar vjetor historik duhet t'i nënshtrohet auditimit të pavarur.

Pika 18.3.2	Deklarim i informacioneve të tjera në dokumentin e regjistrimit, që janë audituar nga audituesit.
Pika 18.3.3	Kur të dhënat financiare në dokumentin e regjistrimit nuk janë marrë nga pasqyrat e audituara financiare të emetuesit, të deklarohet burimi i informacionit dhe fakti që informacioni është i paaudituar.
Pika 18.3.4	Përshkrim i çdo ndryshimi të rëndësishëm në gjendjen financiare apo tregtare të grupit, që ka ndodhur deri në fund të periudhës së fundit financiare, për të cilën është publikuar pasqyra financiare e audituar ose informacioni i ndërmjetëm financiar. Në të kundërt, duhet paraqitur një pasqyrë me vlerë negative.
Pika 18.4	Politika e dividendëve.
Pika 18.4.1	Përshkrim i politikës së emetuesit për shpërndarjen e dividendëve dhe kufizimet e saj. Nëse emetuesi nuk e ka një politikë të tillë, të përfshihet pasqyra përkatëse me vlerë negative.
Pika 18.4.2	Vlera e dividendit për aksion për secilin vit financiar për periudhën që mbulojnë të dhënat financiare historike, të korrigjuara, kur ka pasur ndryshim të numrit të aksioneve të emetuesit, për ta bërë këtë informacion të krahasueshëm.
Pika 18.5	Procedurat ligjore dhe të arbitrazhit.
Pika 18.5.1	Informacion për çdo procedurë shtetërore, ligjore ose arbitrazhi (përfshi procese, që janë ende të papërfunduara apo që pritet të fillojnë, për të cilat emetuesi ka dijeni) gjatë një periudhe që shtrihet të paktën gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit që mund të ketë ose ka pasur në të shkuarën e afërt pasoja të konsiderueshme mbi pozicionin financiar ose fitimet e emetuesit dhe/ose grupit, ose të paraqitet pasqyra përkatëse me vlerë negative.
RUBRIKA 19	INFORMACION SHITESË
Pika 19.1	Kapitali aksionar Informacioni i parashikuar në pikat 18.1.2 deri në 18.1.2 për të dhënat financiare historike deri datën e bilancit më të fundit:
Pika 19.1.1	Shuma e kapitalit të emetuar dhe për çdo klasë të aksioneve përfshin: (a) numrin total të aksioneve të emetuesit; (b) numrin e aksioneve të emetuara dhe të paguara plotësisht dhe të emetuara, por jo të paguara plotësisht;

	(c) vlerën nominale për aksion (d) një rakordim të numrit të aksioneve të papaguara në fillim dhe në fund të vitit financiar
Pika 19.1.2	Një historik të kapitalit aksionar, që nxjerr në pah informacionet mbi ndryshimet e ndodhura për periudhën që mbulon informacioni financiar historik.
Pika 19.2	Akti i themelimit dhe statuti.
Pika 19.2.1	Regjistrimi në regjistrin tregtar, numri i regjistrimit, nëse ka dhe një përshkrim i shkurtër i objektivave dhe qëllimeve të emetuesit dhe se ku mund të gjenden këto të dhëna në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.
Pika 19.2.2	Kur ka më shumë se një klasë aksionesh, një përshkrim i të drejtave, preferencave dhe kufizimeve që lidhen me secilën prej tyre.
Pika 19.2.3	Një përshkrim i shkurtër i çdo dispozite të aktit themelues, statutit apo akteve të brendshme të emetuesit, që do të kishin për pasojë vonimin, shtyrjen ose pengimin e një ndryshimi në kontrollin e emetuesit.
RUBRIKA 20	KONTRATAT THEMELORE
Pika 20.1	Përmbledhje të secilës kontratë themelore, që nuk është kontratë e lidhur gjatë veprimtarisë së zakonshme tregtare, ku emetuesi ose anëtarët e grupit janë palë gjatë dy viteve të fundit që i paraprijnë publikimit të dokumentit të regjistrimit. Një përmbledhje e çdo kontrate tjetër (që nuk është kontratë e lidhur gjatë aktivitetit të zakonshëm tregtar), e lidhur nga çdo anëtar i grupit, e cila përmban dispozita sipas të cilave çdo anëtar i grupit ka detyrime ose të drejta, që, në datën e dokumentit të regjistrimit, ka rëndësi themelore për grupin.
RUBRIKA 21	DOKUMENTET NË DISPOZICION
Pika 21.1	Një deklaratë se përgjatë afatit të vlefshmërisë së prospektit, dokumentet e mëposhtme mund të kontrollohen, sipas rastit: (a) statuti dhe akti i themelimit i emetuesit në variantin e tyre të fundit; (b) të gjitha raportet, letrat dhe dokumentet, vlerësimet dhe deklaratat e tjera të përgatitura nga ekspertët me kërkesë të emetuesit, pjesë e të cilave janë përfshirë ose përmendur në dokumentin e regjistrimit; (c) të dhënat financiare historike të emetuesit ose, në rastin e grupit, të dhënat

	<p>historike financiare për emetuesin dhe shoqëritë e kontrolluara të tij, për secilin prej dy viteve financiare që i paraprijnë datës së publikimit të dokumentit të regjistrimit. Adresa e faqes së internetit, ku mund të konsultohen dokumentet me anë të mjeteve fizike ose elektronike.</p>
--	---

SHTOJCA III – FORMATI STANDARD PËR SHËNIMIN MBI TITULLIN

RUBRIKA 1	PERSONAT PËRGJEGJËS, INFORMACIONI NGA PALËT E TRETA, RAPORTET E EKSPERTËVE DHE MIRATIMI I AUTORITETIT KOMPETENT
Pika 1.1	Identifikoni të gjithë personat përgjegjës për informacionin ose pjesë të tij, që paraqitet në shënimin e titullit, duke shënuar, për rastin e dytë, cilat janë këto pjesë. Në rastin e personave fizikë, përfshi anëtarë të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit, shënoni emrin dhe funksionin e personit; në rastin e personave juridikë, shënoni emrin dhe adresën e regjistruar.
Pika 1.2	<p>Një deklaratë nga personat përgjegjës për titujt që, në dijeninë e tyre, informacioni që përfshihet në shënimin e titullit është në përputhje me faktet dhe se shënimi i titujve nuk ka lënë jashtë asnjë informacion që mund të ndikojë në kuptimin e tij.</p> <p>Kur është rasti, një deklaratë nga personat përgjegjës për pjesë të caktuara të shënimit të titujve që, në dijeninë e tyre, informacioni që përfshihet në ato pjesë të shënimit të titujve, për të cilin ata janë përgjegjës, është në përputhje me faktet dhe se ato pjesë të shënimit të titujve nuk lënë jashtë asnjë informacion që mund të cenojë kuptimin e tyre.</p>
Pika 1.3	<p>Kur një deklaratë a raport që i atribuohet një personi si ekspert përfshihet në dokumentin e regjistrimit, jepni të dhënat e personit për emrin, adresën e biznesit, kualifikimet dhe interesin material të emetuesit, nëse ka.</p> <p>Nëse deklarata ose raporti janë hartuar me kërkesë të emetuesit, shënoni që deklarata ose raporti është përfshirë në shënimin e titujve me miratimin e personit, i cili ka autorizuar përmbajtjen e asaj pjese të shënimit të titujve, për qëllimet e prospektit.</p>
Pika 1.4	Kur informacioni është marrë nga palë të treta, konfirmoni që ky informacion është riprodhuar saktësisht dhe për aq sa emetuesi ka dijeni apo është në gjendje të vërtetojë nga informacioni i publikuar nga kjo palë e tretë, nuk është hequr asnjë fakt që do ta bënte informacionin e riprodhuar të pasaktë ose çorientues. Përveç kësaj, identifikoni burimin/burimet e informacionit.
RUBRIKA 2	FAKTORËT E RREZIKUT
Pika 2.1	<p>[Për titujt e pjesëmarrjes në kapital]:</p> <p>Një përshkrim i rreziqeve materiale që janë specifike për titujt e ofruar dhe të pranuar për t’u treguar në një numër të kufizuar kategorish, në një rubrikë të titulluar, ‘Faktorët e rrezikut’.</p> <p>Në secilën kategori, të parat do të renditen rreziqet më të rëndësishme, sipas vlerësimit të emetuesit, duke marrë parasysh ndikimin negativ tek emetuesi</p>

	<p>dhe titujt dhe gjasat që ato të ndodhin. Rreziqet do të mbështeten nga përmbajtja e shënimit të titujve.</p> <p>[Për titujt jo të pjesëmarrjes në kapital]:</p> <p>Përshkrim i rreziqeve themelore janë specifike për titujt e ofruar dhe të pranuar për t'u treguar në një numër të kufizuar kategorish, në një rubrikë të titulluar, 'Faktorët e rrezikut'.</p> <p>Rreziqet që do të deklarohen përfshijnë ato që vijnë si rezultat i nënrenditjes së titullit dhe ndikimit në masën apo afatin e pritshëm të pagesave ndaj mbajtësit të titujve në rast falimenti ose çdo procedure tjetër të ngjashme, dhe në rastet kur titujt janë të garantuar, rreziqet specifike dhe thelbësore që lidhen me garantin në atë pikë në të cilën ndikojnë në aftësinë e tij për të përmbushur angazhimin e tij në bazë të garancisë. Në secilën kategori, të parat do të përcaktohen rreziqet më të rëndësishme, sipas vlerësimit të emetuesit, ofertuesit ose personit që kërkon pranim për tregtim në një treg të rregulluar, duke marrë në konsideratë ndikimin negativ mbi emetuesin dhe titujt, si dhe gjasat që ato të ndodhin. Rreziqet mbështeten nga informacioni në përmbajtjen e shënimit të titujve.</p>
RUBRIKA 3	INFORMACION THEMELOR
Pika 3.1	<p>[Për titujt e pjesëmarrjes në kapital]:</p> <p>Deklarata e kapitalit të punës</p> <p>Deklaratë nga emetuesi se, sipas mendimit të tij, kapitali i punës është i mjaftueshëm për kërkesat aktuale të emetuesit ose, nëse nuk është kështu, si propozon të sigurojë kapitalin e nevojshëm shtesë të punës.</p> <p>[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Pika 3.1 nuk kërkohet</p>
Pika 3.2	<p>[Për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Kapitalizimi dhe borxhi</p> <p>Një deklaratë kapitalizimi dhe borxhi të përditësuar dhe jo më të vjetër sesa 90 ditë nga data e dokumentit. Termi 'borxh' përfshin edhe borxhin e tërthortë dhe të kushtëzuar.</p> <p>Në rast ndryshimesh thelbësore në gjendjen e kapitalizimit dhe borxhit të emetuesit brenda një periudhe prej [90] ditësh, jepen të dhëna shtesë përmes paraqitjes së një përshkrimi të këtyre ndryshimeve ose përmes përditësimit të shifrave përkatëse.</p> <p>[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Pika 3.2 nuk kërkohet</p>
Pika 3.3	<p>Interesi i personave fizikë dhe juridikë të përfshirë në emetim/ofertë</p> <p>Përshkrim i të gjitha interesave, përfshi konfliktin e interesit, që ka ndikim në emetim/ofertë, duke dhënë detaje për personat e përfshirë dhe natyrën e interesit.</p>

Pika 3.4	<p>Arsyet e ofertës dhe përdorimi i të ardhurave [Për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Arsyet për ofertën dhe, sipas rastit, për vlerën e përlogaritur të të ardhurave të zërthyer në bazë të secilit përdorim kryesor të synuar dhe të paraqitura në rend përparësie të këtyre përdorimeve. Nëse emetuesi është i vetëdijshëm se të ardhurat e parashikuara nuk do të jenë të mjaftueshme për të financuar të gjitha përdorimet e propozuara, deklaroni vlerën dhe burimet e fondeve të tjera të nevojshme. Duhet dhënë hollësi edhe lidhur me përdorimin e të ardhurave, veçanërisht kur përdoren për blerjen e aktivëve, që nuk janë pjesë e veprimtarisë së zakonshme tregtare, për të financuar blerjet e deklaruara të bizneseve të tjera ose për të shkarkuar, ulur ose shlyer borxhin.</p> <p>[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Arsyet për ofrimin e titujve publikut dhe pranimin për t'u tregtuar. Kur është e nevojshme, deklarohen shpenzimet e përgjithshme të vlerësuara të emetuesit/ofertës dhe vlera e përlogaritur neto e të ardhurave. Këto shpenzime dhe të ardhura zërthehen në bazë të secilit përdorim kryesor të synuar dhe të paraqitura në rend përparësie të këtyre përdorimeve. Nëse emetuesi është i vetëdijshëm se të ardhurat e parashikuara nuk do të jenë të mjaftueshme për të financuar të gjitha përdorimet e propozuara, deklaroni vlerën dhe burimet e fondeve të tjera të nevojshme.</p>
RUBRIKA 4	INFORMACION RRETH TITUJVE QË OFROHEN/PRANOHEN PËR TREGTIM
Pika 4.1	Përshkrim i llojit dhe klasës së titujve që do të ofrohen dhe do të pranohen për tregtim, përfshi kodin ndërkombëtar të identifikimit të titujve ('ISIN').
Pika 4.2	Legjislacioni në bazë të të cilit janë krijuar titujt.
Pika 4.3	Të dhëna nëse titujt janë në formë të regjistruar apo si instrumente të mbajtësit dhe nëse titujt janë në formë certifikate apo të regjistruar në regjistrin kontabël. Në rastin e fundit, deklarohet emri dhe adresa e subjektit të ngarkuar për mbajtjen e të dhënave.
Pika 4.3.1	<p>[Vetëm për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Vlera e përgjithshme e titujve që i ofrohen publikut/pranohen për tregtim. Nëse vlera nuk është fikse, të deklarohet vlera maksimale e titujve që do të ofrohen (nëse është e vlefshme) dhe një përshkrim i rregullave dhe afatit për shpalljen në publik të vlerës përfundimtare të ofertës.</p>
Pika 4.4	Monedha e titujve të emtuar.
Pika 4.4.1	<p>[Vetëm për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Prioriteti relativ i titujve në strukturën e kapitalit në rast falimentimi, përfshi, kur është rasti, informacione mbi shkallën e nënrenditjes së titujve.</p>

Pika 4.5

Përshkrim i të drejtave që lidhen me titujt, përfshi kufizimet e këtyre të drejtave dhe procedurën për ushtrimin e këtyre të drejtave:

[Për titujt me pjesëmarrje në kapital]:

të drejtat mbi dividendin:

- (i) data/datat fikse në të cilat lind e drejta;
- (ii) afati pas të cilit pushon e drejta për dividend dhe deklarimi i personit në favor të të cilit shkon e drejta e pushuar;
- (iii) Kufizimet dhe procedurat për shpërndarjen e dividendit për mbajtësit jorezidentë;
- (iv) norma e dividendit ose metoda e përlogaritjes së tij, shpeshësia dhe natyra me akumulim ose pa akumulim e pagesave;

të drejtat e votës;

të drejtat e blerjes paraprake për nënshkrimin e titujve të së njëjtës klasë;

e drejta për ndarjen e fitimeve të emetuesit;

e drejta për ndarjen e çdo teprice, në rast likuidimi;

dispozitat e riblerjes;

dispozitat e konvertimit.

[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:

- norma nominale e interesit
- dispozitat që lidhen me interesin e pagueshëm
- data prej së cilës interesi bëhet i pagueshëm
- datat e shlyerjes së interesit
- afati i vlefshmërisë së pretendimeve kundrejt interesit dhe shlyerjes së principalit

Kur norma nuk është fikse:

- deklaratë që përcakton llojin e bazës së përlogaritjes
- përshkrim të instrumentit bazë mbi të cilin bazohet norma
- metoda e përdorur për të lidhur normën me instrumentin bazë
- të dhëna se ku mund të përftohet përmes mjeteve elektronike informacioni mbi performancën e shkuar dhe të ardhshme të instrumentit bazë dhe paqëndrueshmërinë e tij dhe nëse ky informacion mund të merret ose jo pa pagesë
- përshkrim i çrregullimeve në treg ose në shlyerje që prekin instrumentin bazë
- çdo rregull korrigjues që ka lidhje me ngjarjet që përfshijnë instrumentin bazë
- emri i agjentit që bën llogaritjet

	<ul style="list-style-type: none"> nëse titulli ka komponent derivativ në pagesën e interesit, duhet një shpjegim i qartë dhe gjithëpërfshirës, për të ndihmuar investuesit të kuptojnë sesi ndikohet vlera e investimit të tyre nga vlera e instrumentit/instrumenteve bazë, veçanërisht në rrethanat kur rreziqet janë më të dukshme. <p>Informacion i mëtejshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> Data e maturimit Hollësi rreth marrëveshjeve të amortizimit të huasë, përfshi procedurat e shlyerjes. Kur mendohet amortizimi me paradhënie, me nismën e emetuesit ose të mbajtësit, ai do të përshkruhet duke përcaktuar kushtet dhe kriteret e amortizimit Përshkrimi në formë të përmbledhur i metodës përmes së cilës përlllogaritet kthimi
Pika 4.5.1	<p>[Vetëm për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Paraqitje e mbajtësve të titujve pa pjesëmarrje në kapital, përfshi identifikimin e organizatave që përfaqësojnë investuesit dhe dispozitat që zbatohen për këtë përfaqësim. Informacion rreth faqes së internetit ku publiku mund të ketë qasje pa pagesë në kontratat që lidhen me këto forma përfaqësimi.</p>
Pika 4.6	Në rast emetimesh të reja, një deklaratë për zgjidhjet, autorizimet dhe miratimet përmes të cilave është krijuar ose do të krijohet dhe/ose do të emetohet titulli.
Pika 4.7	Në rastin e emetimeve të reja, data e pritshme e emetimit të titujve.
Pika 4.8	Një përshkrim i kufizimeve të transferueshmërisë së titujve.
Pika 4.9	<p>[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Deklaratë për ekzistencën e legjislacionit kombëtar mbi blerjet që zbatohen për emetuesin, që mund të krijojnë pengesa për blerjen, nëse ka.</p> <p>Një përshkrim i shkurtër i të drejtave dhe detyrimeve të aksionarëve, në rast ofertash të detyrueshme blerjeje dhe/ose rregullat e nxjerrjes jashtë ose rregullat e shitjes në raport me titujt.</p>
Pika 4.10	<p>[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Informacion për ofertat publike të blerjes nga palët e treta në raport me kapitalin e emetuesit, që janë bërë gjatë vitit të fundit financiar dhe gjatë atij aktual. Duhet deklaruar çmimi ose kushtet e shkëmbimit bashkëlidhur me ofertën dhe rezultati përkatës.</p>
Pika 4.11	Një paralajmërim që legjislacioni tatimor i shtetit të investuesit dhe vendit të themelimit të emetuesit mund të ndikojnë në të ardhurat e përftuara nga titujt.

	Informacion mbi trajtimin tatimor të titujve, kur investimi i propozuar përballet me një regjim tatimor të posaçëm për këtë lloj investimi.
RUBRIKA 5	KUSHTET DHE KRITERET PËR OFRIMIN E TITUJVE PUBLIKUT
Pika 5.1	Kushtet, statistikatat e ofertës, kalendari i pritshëm dhe veprimet e nevojshme për të aplikuar për ofertën.
Pika 5.1.1	Kushtet të cilave u nënshtrohet oferta.
Pika 5.1.2	[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]: Vlera e përgjithshme e emetimit/ofertës, ku dallohen titujt e ofruar për shitje dhe ata të ofruar për nënshkrim; nëse vlera nuk është fikse, të dhëna mbi vlerën maksimale të titujve që do të ofrohen (nëse ka) dhe një përshkrim të rregullave dhe afatit për shpalljen publikut të vlerës përfundimtare të ofertës. Në rast se në prospekt nuk mund të jepet vlera maksimale, prospekti përcakton se pranimet e blerjes ose nënshkrimit të titujve mund të tërhiqen për jo më pak se dy ditë pune pasi është paraqitur sasia e titujve që do t'i ofrohen publikut.
Pika 5.1.3	Periodha kohore, përfshi çdo ndryshim të mundshëm, gjatë së cilës do të hapet oferta përshkrim i procesit të aplikimit.
Pika 5.1.4	[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]: Një shënim se kur dhe në cilat rrethana mund të tërhiqet ose pezullohet oferta dhe nëse tërheqja mund të bëhet pas nisjes së tregtimit.
Pika 5.1.5	Një përshkrim të mundësive për uljen e nënshkrimeve dhe mënyrës për të rimbursuar shumatat e paguara tepër nga kërkuesit.
Pika 5.1.6	Hollësi mbi vlerën minimale dhe/ose maksimale të kërkesës (qoftë në numër titujsh apo vlerë të përgjithshme që do të investohet.
Pika 5.1.7	Informacion rreth periudhës në të cilët kërkesa mund të tërhiqet, me kusht që investuesit të lejohen të tërheqin nënshkrimin e tyre.
Pika 5.1.8	Metodën dhe afatin e pagesës së titujve dhe dorëzimit të titujve.
Pika 5.1.9	Përshkrim i plotë i mënyrës dhe datës kur do të bëhen publike rezultatet e ofertës.
Pika 5.1.10	Procedura për ushtrimin e të drejtave të parablerjes, negociueshmërisë së nënshkrimit dhe trajtimit të të drejtave të paushtruara të nënshkrimit.

Pika 5.2	Plani i shpërndarjes dhe caktimit.
Pika 5.3	Çmimi i vendosur
Pika 5.3.1	<p>[Për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Informacion për çmimin me të cilin ofrohen titujt dhe vlera e shpenzimeve dhe tatimeve që i ngarkohen nënshkruesit ose blerësit.</p> <p>Nëse çmimi nuk dihet, atëherë, deklaroni:</p> <p>(a) çmimin maksimal, nëse është i disponueshëm;</p> <p>(b) metodën dhe kriteret dhe/ose kushtet e vlerësimit, në përputhje me të cilat është përcaktuar ose do të përcaktohet oferta e çmimit përfundimtar dhe një shpjegim të metodave të vlerësimit që janë përdorur.</p> <p>Kur as pika (a), as (b) nuk mund të paraqiten në shënimin e titullit, shënimi i titullit do të përfshijë specifikisht se pranimet e blerjes ose nënshkrimit të titujve mund të tërhiqen jo më vonë se deri në dy ditë pune pasi është paraqitur çmimi i ofertës përfundimtare i titujve që do t'i ofrohen publikut.</p> <p>[Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Deklarim i çmimit të pritshëm me të cilin do të ofrohen titujt. Kur nuk është e mundur të jepet çmimi i pritshëm, një përshkrim i metodës së përcaktimit të çmimit. Dhënie e vlerës së shpenzimeve dhe taksave që i ngarkohen nënshkruesit ose blerësit.</p>
Pika 5.3.2	<p>[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Procesi i deklarimit të çmimit të ofertës.</p>
Pika 5.3.3	<p>[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Nëse mbajtësi i kapitalit i emetuesit ka të drejta parablerjeje dhe kjo e drejtë kufizohet ose tërhiqet, përshkrimi i bazës për çmimin e emetimit, nëse emetimi bëhet kundrejt parasë, së bashku me arsyet dhe përfituesit e këtij kufizimit ose tërheqjeje.</p>
Pika 5.3.4	<p>[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]:</p> <p>Kur ka ose mund të ketë pabarazi thelbësore midis çmimit të ofertës publike dhe kostos efektive në para për anëtarët e organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse ose bashkëpunëtorët të titujve të blerë prej tyre në transaksione gjatë vitit të fundit ose të cilat ata kanë të drejtë të blejnë, përfshini një krahasim të kontributit në ofertën e propozuar publike dhe kontributet e dhëna në para të këtyre personave.</p>
Pika 5.4	Hedhja në treg dhe nënshkrimi
Pika 5.4.1	Emri dhe adresa e koordinitorit/koordinatorëve të ofertës globale dhe pjesëve

	të veçanta të ofertës dhe, për aq sa ka dijeni në emetim, personave që e hedhin në treg në vende të ndryshme ku bëhet oferta.
Pika 5.4.2	Emri dhe adresa e agjentëve pagues dhe agjentëve depozitarë.
Pika 5.4.3	Emri dhe adresa e subjekteve që bien dakord të nënshkruajnë emetimin mbi baza angazhimi të përcaktuar dhe emrin e adresën e subjekteve që bien dakord të hedhin në treg emetimin pa angazhim të përcaktuar ose sipas rregullave të ‘përpyekjeve’ më të mira. Informacion mbi tiparet themelore të marrëveshjeve, përfshi kuotat. Kur jo i gjithë emetimi është nënshkruar, një deklaratë mbi pjesën që nuk mbulohet. Informacion mbi shumën e përgjithshme të komisionit të nënshkrimit dhe komisionit të hedhjes në treg.
Pika 5.4.4	Kur është lidhur ose do të lidhet marrëveshja e nënshkrimit.
RUBRIKA 6	PRANIMI PËR TREGTIM DHE RREGULLAT E TREGTIMIT
Pika 6.1	Kërkesa për pranim për t’u tregtuar, me qëllim shpërndarjen në një treg të rregulluar.
Pika 6.2	Tregjet e rregulluara në të cilat, me sa ka dijeni emetuesi, titujt e së njëjtës klasë titujsh që do të ofrohen apo pranohen për tregtim, janë pranuar tashmë për t’u tregtuar.
Pika 6.3	[Për titujt me pjesëmarrje në kapital]: Nëse njëkohësisht ose thujse njëkohësisht me kërkesën për pranimin e titujve në një treg të rregulluar, titujt e së njëjtës klasë nënshkruhen ose hidhen privatisht në treg ose nëse krijohen tituj të klasave të tjera për publikun apo hedhjen privatisht në treg, jepni hollësi lidhur me natyrën e këtyre ndërhyrjeve dhe me numrin, karakteristikat dhe çmimin e titujve me të cilët kanë lidhje. Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]: Emri dhe adresa e subjekteve që kanë angazhim të përcaktuar për të vepruar si ndërmjetës në tregun dytësor, duke ofruar likuiditet përmes normave të blerjeve dhe ofertës dhe përshkrim i kriterëve kryesore për angazhimin e tyre.
Pika 6.4	[Për titujt me pjesëmarrje në kapital]: Për pranimin për tregtim në një treg të rregulluar, hollësi rreth subjekteve që kanë ofruar angazhim të përcaktuar për të vepruar si ndërmjetës në treg dytësor, duke ofruar likuiditet përmes normave të blerjeve dhe ofertës dhe përshkrim i kriterëve kryesore për angazhimin e tyre. [Për titujt pa pjesëmarrje në kapital]: Çmimi i emetimit të titujve
RUBRIKA 7	MBAJTËSIT QË SHESIN TITUJT

	[Vetëm për titujt me pjesëmarrje në kapital]
Pika 7.1	Emri dhe adresa e aktivitetit tregtar të subjektit që ofron të shesë titujt, natyra e pozicioneve ose marrëdhënieve të tjera thelbësore që shitësi ka mbajtur gjatë tre vjetëve të fundit me emetuesin ose me ndonjë prej paraardhësve apo bashkëpunëtorëve.
Pika 7.2	Numri dhe klasa e titujve të ofruar nga secili prej mbajtësve që shesin titujt.
Pika 7.3	Kur një aksionar me pjesëmarrje të lartë shet titujt, pjesën e aksioneve që zotëron si përpara, ashtu edhe menjëherë pas emetimit.
RUBRIKA 8	SHPENZIMET E EMETIMIT/OFERTËS
Pika 8.1	Të ardhurat e përgjithshme neto dhe një vlerësimi shpenzimeve të përgjithshme të emetimit/ofertës.
RUBRIKA 9	INFORMACION SHITESË
Pika 9.1	Nëse këshilltarët që kanë lidhje me një emetim përmenden në Shënimin e Titullit, deklaratë për cilësinë me të cilën kanë vepruar këshilltarët.
Pika 9.2	Përfshirje e informacioneve të tjera në shënimin e titullit, që janë audituar ose kontrolluar nga audituesit ligjorë dhe kur audituesit kanë hartuar një raport, riprodhim të raportit ose, me lejen e autoritetit kompetent, përmbledhje të raportit.
Pika 9.3	[Vetëm për titujt pa pjesëmarrje në kapital]: Klasifikimi i rrezikut të kreditit që lidhet me titujt, me kërkesë ose në bashkëpunim me emetuesin gjatë procesit të vlerësimit. Një shpjegim i shkurtër se çfarë nënkuptojnë klasifikimet, nëse kjo është publikuar më parë nga ofruesi i klasifikimit.

SHTOJCA IV – FORMATI STANDARD I PËRMBLEDHJES

[Identiteti dhe të dhënat e kontaktit të emetuesit, përfshi numrin e identitetit si person juridik (NIPT-i)]

[Identiteti dhe të dhënat e kontaktit të Autoritetit ose autoritetit kompetent të vendit të origjinës që miraton prospektin]

[Lloji dhe klasa e titullit]

[Numri kombëtar ose ndërkombëtar i identifikimit të titullit – të përfshihet pas marrjes dhe paraqitjes tek Autoriteti]

[Norma e interesit, nëse duhet]

[PERIUDHA E OFERTËS]

[Data e miratimit të prospektit – të përfshihet pas miratimit nga Autoriteti]

INVESTIMI NË KËTË TITULL SHOQËROHET ME RREZIQE. FAKTORËT E RREZIKUT TË EMETUESIT DHE TË TITULLIT PËRSHKRUEHEN NË KËTË PROSPEKT DHE DUHEN LEXUAR ME KUJDES.

RUBRIKA 1 – Hyrje dhe paralajmërime

DEKLARATA E EMETUESIT

Me besim të plotë dhe bazuar në gjithë informacionin dhe të dhënat e paraqitura në prospektin e përbërë nga dokumenti i regjistrimit, shënimi i titullit dhe kjo përmbledhje, deklarojmë se i gjithë informacioni dhe të dhënat e përfshira përbëjnë paraqitjen e plotë dhe aktivet e pasivet, fitimet dhe humbjet, situatën financiare dhe veprimtaritë reale të emetuesit, të të drejtave që lidhen me titullin që do t'i ofrohet publikut dhe do të pranohet për t'u tregtuar në një treg të rregulluar dhe se i gjithë informacioni dhe data e paraqitur këtu janë të sakta e korrekte dhe se nuk është hequr asnjë informacion apo të dhëna që ndikojnë në saktësinë dhe tërësinë e informacionit.

Nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i emetuesit]

NJOFTIME TË RËNDËSISHME PËR INVESTUESIN

Ky prospekt, i përbërë prej dokumentit të regjistrimit, shënimit të titullit dhe kësaj përmbajtjeje, përmban informacione të rëndësishme mbi emetuesin dhe titullin. Po ashtu, prospekti i përbërë prej dokumentit të regjistrimit, shënimit të titullit dhe kësaj përmbajtjeje, përshkruan rreziqet që shoqërojnë emetuesin dhe rreziqet shoqëruese të investimit në titull.

Rekomandohet të lexoni dhe të kuptoni plotësisht përmbajtjen e të gjithë prospektit, përpara se të merrni një vendim për të investuar në titull. Për rrjedhojë, kjo përmbledhje duhet lexuar vetëm si hyrje.

PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN QË PËRMBAN PROSPEKTI

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionin dhe të dhënat që përmban ky prospekt, i përbërë prej dokumentit të regjistrimit, shënimit të titullit dhe kësaj përmbajtjeje. Informacionet janë në përputhje me faktet dhe nuk lënë jashtë asnjë informacion që do të cenonte vlerën e tij. Kur përdoren informacione nga burimet e palëve të treta, këto informacione riprodhohen në mënyrë të saktë dhe emetuesi është në gjendje të shpjegojë qartësisht informacionin e publikuar nga kjo palë e tretë dhe nuk lihet jashtë asnjë fakt që do ta bënte informacionin e riprodhuar të pasaktë apo çorientues.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare verifikon vetëm nëse prospekti, i përbërë prej dokumentit të regjistrimit, shënimit të titullit dhe kësaj përmbajtjeje, përmban të gjithë informacionin e përcaktuar në Ligjin Nr. 62/2020, 'Për tregjet e kapitalit' dhe kërkesat rregullatore.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk ka verifikuar saktësinë dhe korrektesën e informacionit që përmban ky prospekt, i përbërë prej dokumentit të regjistrimit, shënimit të titullit dhe kësaj përmbajtjeje.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk jep rekomandime për askënd në lidhje me përshtatshmërinë e investimit në tituj. Çdo investues është përgjegjës për vendimin e tij bazuar në informacionet që përmban ky prospekt dhe, nëse është i pasigurt në raport me një investim, duhet të këshillohet me një profesionist.

RUBRIKA 2 – Të dhënat kryesore të emetuesit

Pika 1	Emetuesi i titujve
Pika 1.1	Selia qendrore dhe personaliteti juridik i emetuesit, NIPT - i, ligji në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë dhe vendi i themelimit
Pika 1.2	Veprimtaritë kryesore të emetuesit
Pika 1.3	Aksionarët me pjesëmarrje të lartë, përfshi nëse është nën pronësi ose kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe nga kush
Pika 1.4	Identiteti i drejtorëve kryesorë administrativë
Pika 1.5	Identiteti i audituesve të tij ligjorë
Pika 2	Informacion kryesor financiar për tri vitet e shkuara (ose për një afat më të shkurtër, në varësi të krijimit të emetuesit) (Duhet të përfshihet informacioni i bilancit të fundvitit)
Pika 3	Rreziqet kryesore të emetuesit

RUBRIKA 3 – TIPARET KRYESORE TË TITUJVE

Pika 1	Tiparet kryesore të titujve
Pika 1.1	Lloji, klasa dhe numri ndërkombëtar ose kombëtar i identifikimit i emetuesit – përfshihet kur merret dhe i paraqitet Autoritetit
Pika 1.2	Monedha, prerja, vlera nominale, numri i titujve dhe afati i titujve – kur është rasti
Pika 1.3	Të drejtat që lidhen me titullin e emetuesit
Pika 1.4	Përparësia relative e titujve në strukturën e kapitalit të emetuesit në rast falimenti, përfshi, kur është nevoja, informacione për shkallën e nënrenditjes së titujve të emetuesit
Pika 1.5	Kufizimet për transferimin lirisht të titujve të emetuesit
Pika 1.6	Kur është e nevojshme, politikën e dividendit dhe pagesave të emetuesit
Pika 2	Tregtimi i titujve (Përcaktimi i tregut të rregulluar ku tregtohen titujt)
Pika 3	Garancitë që u lidhen me titujt (nëse ka)
Pika 3.1	Përshkrimi i natyrës dhe objektit të garancisë
Pika 3.2	Përshkrim i garantit, përfshi NIPT-in e tij
Pika 3.3	Informacioni kryesor financiar përkatës për qëllime vlerësimi të aftësisë së garantit për të përmbushur angazhimet e tij, në bazë të garancisë
Pika 3.4	Përshkrim i shkurtër i faktorëve më të rëndësishëm të rrezikut që lidhen me garantin, që përfshihen në prospekt
Pika 4	Rreziqet kryesore që janë specifike për titujt

RUBRIKA 4 – INFORMACIONE KRYESORE PËR TITUJT

Pika 1	<p>Kushtet dhe kalendari i titujve, përfshi</p> <ul style="list-style-type: none"> • kriteret e përgjithshme • kushtet dhe kalendari i pritshëm i ofertës
--------	---

	<ul style="list-style-type: none"> • hollësitë e pranimi për tregtim në një treg të rregulluar • planin e shpërndarjes • sasinë dhe përqindjen e rezultatit të menjëhershëm të ofertës • vlerësimin e shpenzimeve të përgjithshme të emetimit, përfshirë vlerësimin e shpenzimeve që i ngarkohen investuesit
Pika 2	<p>Arsyeja e hartimit të prospektit</p> <p>Përshkrim i shkurtër i arsyeve të ofertës dhe, kur është rasti:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdorimi dhe vlera e flukseve monetare neto nga emetimi • të dhëna nëse oferta është objekt i një marrëveshjeje nënshkrimi bazë e një angazhimi të përcaktuar, duke përmendur të gjitha pjesët që nuk mbulohen • të dhëna për konfliktet më të rëndësishme të interesit që lidhen me ofertën dhe pranimin për tregtim në një treg të rregulluar

SHTOJCA V – FORMATI STANDARD I SUPLEMENTIT

RUBRIKA 1	KY FORMAT STANDARD GJEN ZBATIM PËR PROSPEKTET E PARAQITURA SI DOKUMENT I VETËM OSE TË PËRBËRA NGA DISA DOKUMENTE TË VEÇANTA JU LUTEMI, THONI, DUKE SHENJUAR KUTITË NË TË MAJTË, CILIT KRE APO PJESE TË PROSPEKTIT U PËRKASIN SHITESAT (JU LUTEMI, SHENJONI TË GJITHA ATO QË JANË TË VLEFSHME)	
	Prospekti i paraqitur si dokument i vetëm	Prospekti i përbërë nga disa dokumente të veçanta
[•]	Dokumenti i regjistrimit	KREU I
[•]	Shënimi mbi titullin	KREU II
[•]	Përmbledhja	KREU III
RUBRIKA 2	DOKUMENTI I REGJISTRIMIT	
<p>Ju lutemi, shënoni cilës Rubrikë dhe Pikë të kreut të regjistrimit/dokumentit të regjistrimit i përket ndryshimi. Emërtoni dhe referojuni të gjitha pikave dhe rubrikave ku janë bërë ndryshime. Ndryshimet do të paraqiten me paragrafë të vetëm. Nëse nuk janë bërë ndryshime në këtë rubrikë, ju lutemi, shënojeni sipas rastit.</p>		
Rubrika [•] Pika [•]	Prospekti i paraqitur si dokument i vetëm	Prospekti i përbërë nga disa dokumente të veçanta
	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]
	[Ju lutemi, shkruani tekstin/formulimin e mëparshëm këtu]	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]
Rubrika [•] Pika [•]	Prospekti i paraqitur si dokument i vetëm	Prospekti i përbërë nga disa dokumente të veçanta
	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]
	[Ju lutemi, shkruani tekstin/formulimin e mëparshëm këtu]	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]

	këtu]	/formulimin e ndryshuar këtu]
RUBRIKA 3	SHËNIMI MBI TITULLIN	
<p>Ju lutemi përmendni se në cilën rubrikë dhe pikë të kreut të shënimit të titullit/dokumentit të shënimit të titullit është bërë ndryshimi. Emërtoni dhe referojuni të gjitha pikave dhe rubrikave ku janë bërë ndryshime. Ndryshimet do të paraqiten me paragrafë të vetëm. Nëse nuk janë bërë ndryshime në këtë rubrikë, ju lutemi, shënojeni sipas rastit.</p>		
Rubrika [] Pika []	Prospekti i paraqitur si dokument i vetëm	Prospekti i përbërë nga disa dokumente të veçanta
	[Ju lutemi, shkruani tekstin/formulimin e mëparshëm këtu]	[Ju lutemi, shkruani tekstin/formulimin e mëparshëm këtu]
	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]
Rubrika [] Pika []	Prospekti i paraqitur si dokument i vetëm	Prospekti i përbërë nga disa dokumente të veçanta
	[Ju lutemi, shkruani tekstin/formulimin e mëparshëm këtu]	[Ju lutemi, shkruani tekstin/formulimin e mëparshëm këtu]
	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]
RUBRIKA 4	PËRMBLEDHJE	
<p>Ju lutemi shënoni më poshtë se në cilën rubrikë dhe pikë të kreut të përmbledhjes/ dokumentit të përmbledhjes është bërë ndryshimi. Emërtoni dhe referojuni të gjitha pikave dhe rubrikave ku janë bërë ndryshime. Ndryshimet do të paraqiten me paragrafë të vetëm. Nëse nuk janë bërë ndryshime në këtë rubrikë, ju lutemi, shënojeni sipas rastit.</p>		
Rubrika [] Pika []	[Ju lutemi, shkruani tekstin/formulimin e mëparshëm këtu]	
	[Ju lutemi, shkruani tekstin /formulimin e ndryshuar këtu]	

Ju lutemi, nëse është e nevojshme, bëni ndryshime në tabelë nën çdo rubrikë.